

ALJULA JUBANI

MAJA GOJÇAJ

**MËSOJMË DHE PËRDORIM GJUHËN
NË KOMUNIKIM**

GJUHA SHQIPE 5

për klasën e pestë të shkollës fillore

Libri i mësuesit/es



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2025

DR. ALJULA JUBANI MR. MAJA GOJÇAJ

**MËSOJMË DHE PËRDORIM GJUHËN NË KOMUNIKIM
GJUHA SHQIPE 5**

për klasën e pestë të shkollës fillore

Libri i mësuesit/es

**UÇIMO I UPOTREBLJAVAMO JEZIK U KOMUNIKACIJI
ALBANSKI JEZIK 5**

Za peti razred osnovne škole

Priručnik

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensues: Dr. Haxhi Shabani

Luigj Junçaj

Mr. Marjan Lulgjuraj

Dr. Gëzim Dibra

Dr. Arben Hoti

Lektor: Sidorela Berishaj

Korrektor: Marjan Lulgjuraj

Dizajni dhe faqosja: Momçilo Qorsoviq

Ilustrimet: Mersiha Resulbegović

Redaktore teknike: Dajana Vukçević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2572-4

COBISS.CG-ID 36401412

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-6, datë 16.07.2025 e ka miratuar këtë Komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright © Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

Teksti mësimor “Mësojmë dhe përdorim gjuhën në komunikim - Gjuha 5” është një vazhdim i drejtpërdrejtë i teksteve të gjuhës shqipe për klasën I, II, III e IV, me synime të qarta për përvetësimin e gjuhës shqipe, duke pasur në vëmendje zhvillimin e aftësive të tyre të të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Këto tekste janë shkruar me synimin për t’u ofruar njohuritë gramatikore, si një mjet për zhvillimin e kompetencës sa më të plotë komunikative të nxënësve.

Kemi treguar kujdes të respektojmë dhe të vlerësojmë kuadrin socio-kulturor, duke nxitur rolin e ndërveprimit shoqëror dhe kontekstin kulturor në zhvillimin e gjuhës, përnjë mes nxitjes së mësimdhënies së integruar, diskutimeve në grup dhe aktiviteteve që reflektojnë aspektet kulturore shqiptare; të vlerësojmë rëndësinë e kuptimit dhe respektimit të nuancave kulturore në mësimin e gjuhës, duke integruar elemente kulturore në mësimet e gjuhës, nëpërmjet njohjes së traditave, zakoneve dhe praktikave kulturore shqiptare për të pasuruar mësimin e gjuhës dhe për të promovuar mirëkuptimin ndërkulturor; krijimin e aftësisë për të kuptuar aktivisht veçoritë e gjuhës përnjë mes përvojave dhe ndërveprimeve, duke krijuar mësimet që promovojnë zbulimin dhe zgjidhjen e problemeve, duke u dhënë mundësinë nxënësve të eksplorojnë gjuhën përnjë mes aktiviteteve praktike, projekteve dhe ushtrimeve interaktive.

Ndryshimi në strukturë është i dukshëm për shkak të ndryshimit të përmbajtjes së mësimin të gjuhës shqipe, në përputhje me programin lëndor. Synimi kryesor është që nxënësit, pas përfundimit të shkollës fillore, të jenë të aftë për të dëgjuar me vëmendje, për të folur mirë dhe saktë, për të lexuar tekste letrare dhe joletrare.

Në këtë klasë, njohja e veçorive të sistemit të gjuhës letrare shqipe, njohuritë për sistemin gjuhësor dhe drejtshkrimi përfshijnë rregullat e drejtshkrimit për emrat, mbiemrat, përemrat, foljet, numërorët, emërtimet e veprave letrare, revistave dhe gazetave, si dhe të institucioneve, organizatave dhe ndërmarrjeve.

Nxënësit zhvillojnë njohuritë e tyre përnjë mes veprimtarive vetjake, duke u nxitur të zbulojnë njohuritë e reja nën drejtimin e mësuesit. Përzgjedhja e teksteve është bërë duke pasur parasysh interesat dhe aftësitë e nxënësve. Pas secilit tekst, përcaktohen pyetje që nxisin analizën dhe kuptimin e teksteve letrare dhe joletrare.

Synimi përfundimtar është që nxënësit të kuptojnë mirë tekstin dhe ta mbajnë mend atë. Mësimi i gjuhës shqipe kërkon një ekuilibër ndërmjet të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Mësuesi ka detyrën të pasurojë orën e mësimin me tekste nga aktualiteti për të bërë mësimin më interesant dhe aktual.

Përveç leximit, punët me shkrim janë aspekt i rëndësishëm për komunikimin. Nxënësit duhen inkurajuar të përdorin shkrimin si mjet komunikimi, duke i dhënë mundësinë të shkruajnë dhe përmirësojnë shkathtësitë e tyre gramatikore dhe drejtshkrimore. Kjo përvojë do t’i përgatisë ata për përdorimin e gjuhës në situata të ndryshme komunikative, me shkrim dhe me gojë, duke e parë gjuhën si një organizëm të gjallë. Zotërimi i këtyre njohurive do të ndihmojë krijimin e ndërgjegjes gjuhësore të nxënësve dhe aftësinë e tyre për të formësuar si duhet mendimin e për ta shprehur atë sa më qartë me mjetet gjuhësore.

PASQYRA E LËNDËS:

PJESA E PARË

Mësimi 1 Gjuha shqipe, dialektet dhe varianti standard i saj	5
Mësimi 2 Llojet e teksteve	7
Mësimi 3 Si të përgatisim pyetësorë dhe si t'i përdorim të dhënat e mbledhura	9
Mësimi 4 Letra zyrtare dhe letra personale	11
Mësimi 5 Festa, urime dhe ftesa	13
Mësimi 6 Lajmërime publike. Të shkruajmë saktë datën	15
Mësimi 7 Të shkruash një biografi dhe një autobiografi	16

PJESA E DYTË

Mësimi 8 Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm. Përdorimi i shkronjës së madhe. Emrat konkretë dhe emrat abstraktë	18
Mësimi 9 Gjinia dhe numri i emrit	20
Mësimi 10 Parafjalët	21
Mësimi 11 Lakimi i emrave. Emra të lakimit të parë dhe të dytë	22
Mësimi 12 Emrat e lakimit të tretë	23
Mësimi 13 Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm	24
Mësimi 14 Shkallët e mbiemrit	26
Mësimi 15 Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra	27
Mësimi 16 Fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra	29
Mësimi 17 Folja dhe zgjedhimi i saj	31
Mësimi 18 Kohët e thjeshta të foljeve në mënyrën dëftore	33
Mësimi 19 Zgjedhimi i disa foljeve, si: jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha	35
Mësimi 20 Numërorët	37

PJESA E TRETË

Mësimi 21 Llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit	39
Mësimi 22 Theksi i fjalës dhe theksi i fjalisë	41
Mësimi 23 Fjalja dëftore	42
Mësimi 24 Fjalja pohore dhe fjalja mohore	44
Mësimi 25 Fjalja nxitëse dhe dëshirore	46
Mësimi 26 Fjalja pyetëse	48
Mësimi 27 Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë	50
Mësimi 28 Rregullat e shkrimit të ligjërates së drejtë dhe të ligjërates së zhdrejtë	51
Mësimi 29 Kryefjala dhe kallëzuesi, fjalja e thjeshtë	52
Mësimi 30 Kryefjala, si gjymtyrë kryesore dhe me se shprehet ajo	54
Mësimi 31 Kallëzuesi, si gjymtyrë kryesore dhe me se shprehet ai	56
Mësimi 32 Përcaktori	58
Mësimi 33 Kundrinori i drejtë	59
Mësimi 34 Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë	61
Mësimi 35 Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë	63

PJESA E PARË

Mësimi 1

Gjuha shqipe, dialektet dhe varianti standard i saj

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të njohë veçoritë themelore të gjuhës standarde dhe të dialekteve.
- Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të kuptojë drejt gjuhën e përdorur në tekstet e dhëna.
- Të diskutojë për vlerën e dialekteve në pasurimin e fjalorit.
- Të kuptojë dhe të krahasojë nocionet: *gjuhë amtare* (gjuha standarde dhe variantet) *gjuhë zyrtare* dhe *gjuhë e huaj*.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, biseda, punë në grupe.

Korrelacion: natyra, njohuri për shoqërinë

Fjalë kyçe: gjuhë shqipe, dialektet, komunikim verbal dhe joverbal

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor, hartë.

Evokim:

Nxënësit udhëzohen të tregojnë se çfarë dinë për gjuhën standarde dhe dialektet.

Mendimet e tyre shkruhen në tabelë.

Mësuesi me projektor paraqet fotografitë e një vajze, djali, domateje etj. dhe kërkon që nxënësit t'i emërtojnë me fjalët që ata njohin. Shënohen mendimet e ndryshme.

Vajzë, çikë, çupë

Djalë, voc, çun

Domate, mollatarta, lepitkë.

Dallojnë fjalët që përdoren në gjuhën standarde, në dialektin gegë dhe në dialektin toskë.

Realizim kuptimi:

Nxënësit udhëzohen të lexojnë informacionet nga teksti lidhur në gjuhën standarde dhe dialektet.

U përgjigjen pyetjeve:

Cili është dallimi në mes dialekteve dhe shqipes standarde?

Çfarë mësojnë më parë gjatë komunikimit, dialektin apo gjuhën standarde? Arsyeojnë përgjigjet e tyre.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë dhe të thonë se ku e përdorim dialektin, kur shkruajmë në shqipen standarde dhe kur në dialekt, si edhe ku përdoret dialekti toskë dhe ku dialekti gegë.

Mësimdhënësi gjen sa më shumë fjalë të gjuhës standarde dhe përdorimit të tyre në dialekte, të gjitha fjalët janë të vendosura në zarf. Detyrë e nxënësit është të veçojë të gjitha fjalët në gjuhën standarde dhe të gjejë fjalët në dialekte të cilat i përshtaten asaj fjale.

Për ushtrimin 1 në librin e nxënësit, ata lidhin pjesët e fjalive për të formuar pohime të sakta. Në ushtrimin 2 nxënësit punojnë në grup duke gjetur fjalët gjegjëse në gjuhën standarde për fjalët e dhëna.

Ushtrimi 3. Nxënësit analizojnë dhe diskutojnë për fragmentet e dhëna, duke veçuar dialektet në të cilat janë shkruar.

Reflektim.

Ushtrimi 4. Punohet në çift. Njëri nxënës shkruan tri fjali në të folmen e zonës ku jeton; shkëmbejnë fletoret dhe po ato fjali i kalojnë në gjuhën standarde.

Punë me fletore pune

Nxënësit gjejnë nga një fragment të shkruar në gegërisht dhe në toskërisht. Analizohen dhe diskutohen për dallimet në mes tyre.

Ushtrimet 2, 3 dhe 4 punohen në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 2

Llojet e teksteve

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të kuptojë natyrën e teksteve, të parafranojë, interpretojë dhe dallojë si pas formës së shkrimit dhe tematikës.
- Të shprehë në mesazhin e një teksti letrar,
- Të tregojë përshtypjet e veta mbi një tekst letrar.
- Të lexojë, të interpretojë dhe të krijojë tekste letrare dhe joletrare nëpërputhje me moshën e tij.

Metodat dhe teknikat: Të nxënit në bashkëpunim, punë në grupe, të mësojmë duke luajtur.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: tekst letrar, tekst joletrar, udhëzime

Mjetet e mësimi: Teksti mësimor, fletore e punës, kompjuter (tablet), projektor

Evokim:

Rikujtonë njohuritë e fituara nga viti i kaluar.

Në tabelë paraqitet një lojë për nxënësit, loja me zaret. Në anën tjetër, janë të shënuara udhëzimet se si duhet luajtur loja. Secili nxënës i hedh zaret 5 herë dhe në tabelë shënon numrin e pikëve të fituara. Nxënësi, i cili fiton më shumë pikë, është fitues.

Parashトロhet pyetja: si do ta luanin nxënësit lojën, nëse nuk do të merrnin udhëzimet nga mësimdhënësi?

Në vazhdim paraqitet strofa e një poezie, analizohet dhe komentohet së bashkë me nxënësit. Vihet re dallimi në mes teksteve?

Cili ishte dallimi në mes poezisë dhe tekstit me udhëzime?

Realizim kuptimi:

Teksti është njësi komunikimi dhe si i tillë edhe ka funksionin që të komunikojë një në mesazh.

Kuptojnë që tekstet mund të jenë letrare dhe joletrare. Vihet re dallimi në mes tyre duke i udhëzuar të lexojnë informacionet nga teksti mësimor.

Teksti letrar përcjell emocione. Përnjë mes tij shprehet fantazia, ndërsa teksti joletrar nuk ka elemente artistike emocionale.

Në tabelë paraqiten tekstet letrare dhe tekstet joletrare.

Para se të plotësohet ushtrimi i parë diskutohet me nxënësit se çfarë është përmbledhja dhe cilët hapa duhen ndjekur për të shkruar një përmbledhje.

Së bashku me nxënësit shkruhet një ngjarje lidhur me:

Personazhet: (Diana, Dritani, qeni Lesi dhe macja Kiti)

Ku janë: (Diana është në dritare, Dritani, Lesi dhe Kiti janë në rrugë).

Çfarë po bëjnë? (Dritani vrapon pas Lesit dhe Kiti, Diana po i shikon nga dritarja dhe

kënaqet)

Shkruajnë një tekst lidhur me ngjarjen duke veçuar pjesën hyrëse, pjesën kryesore- vazhdimin e ngjarjes apo zhvillimin e ngjarjes dhe përfundimin. Në vazhdim, sipas tekstit të krijuar në mënyrë të njëjtë, plotësohet ushtrimi i parë, duke bërë një përshkrim dhe duke dalluar përshkrimin objektiv dhe subjektiv.

Ushtrimi nr. 2 dhe 3 punohen duke diskutuar së bashku me shokët dhe mësuesin për përgjigjet e sakta.

Reflektim.

Punë me fletore pune. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve

Çfarë është një tekst?

Nga se përbëhet teksti?

A ka ndryshim në mes tekstit letrar dhe joletrar?

Çfarë karakteristikash ka teksti letrar?

Çfarë karakteristikash ka teksti joletrar?

Ushtrimi 2

Gjej fjalët: *paragraf, tekst, letrar, joletrar, kuptim, fjali* (në mësimin e shkronjave të dhëna).

Ushtrimi 3 nxënësit lidhin tekstet e ndryshme me llojin e tyre duke diskutuar dhe përshkruar llojin të cilit i përket.

Ushtrimi 4 plotësohet në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 3

Si të përgatishim pyetësorë dhe si t'i përdorim të dhënat e mbledhura

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të fitojë njohuri se si mund të grumbullojë informacione lidhur me diçka që u intereson;
- Të kuptojë rëndësinë e pyetësorëve.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në çift, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, kultura muzikore.

Fjalë kyçe: tekst, pyetësor, informacion

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim

Mësuesi në projektor paraqet disa nga këngët e mësuara në klasë të 5-të. Me anë të përgjigjes së nxënësve dëgjohet kënga e votuar nga numri më i madh i nxënësve. Në të njëjtën mënyrë, veçojmë disa nga ushqimet më të preferuara të nxënësve.

Realizim kuptimi.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin e dhënë në tekstin mësimor dhe përgjigjen në pyetjet e dhëna lidhur me tekstin.

Përgatitet një pyetësor lidhur me tekstin në të cilin nxënësit përgjigjen dhe në fund diskutohet për rezultate.

A ke qenë te dentisti? Po ____ Jo ____

A i lan dhëmbët para se të shkosh te dentisti? Po ____ Jo ____

A është e rehatshme karrigia e dentistit? Po ____ Jo ____

A shkon te dentisti edhe kur nuk të dhëmbin dhëmbët, për t'i kontrolluar?

Po ____ Jo ____

Të pëlqen shija e pastës së dhëmbëve të dentistit? Po ____ Jo ____

A do të bëhesh dentist kur të rritesh? Po ____ Jo ____.

Ushtrimi 2

Në fjalët e dhëna nxënësit dallojnë fjalën që nuk i takon vargut duke arsyetuar përgjigjen e vet.

Ushtrimi 3

Lexojnë fragmentin e poezisë dhe kërkohet nga nxënësit që ta luajnë në klasë me role dhe pastaj shkruajnë një tregim të shkurtër.

Punë me fletore pune.

Ushtrimi 1.

Nxënësit lidhin përgjigjet me pyetjet e dhëna nga përmbajtja e tekstit nga teksti mësimor.

Reflektim.

Ushtrimi 2. Nxënësit ndahen në grupe, secilit grup i përcaktohet pyetësi të cilin do të hartojë.

Gr. 1 sporti i preferuar;

Gr. 2. loja e preferuar;

Gr. 3. librat e preferuar;

Modeli i pyetjeve

A luan futboll, basketboll apo volejbol?

A luan tenis ose pingpong?

A luan shah?

Të pëlqen të notosh?

A bën ski?

Diskutohet për informacionet e marra.

Ushtrimi 3 punohet në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 4

Letra zyrtare dhe letra personale

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë strukturën e letrës.
- Të dallojë letrën zyrtare nga letra jozyrtare.
- Të shkruajë në mënyrë të pavarur një letër zyrtare ose jozyrtare.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: letra zyrtare, jozyrtare

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Diskutohet në klasë për mënyrën e komunikimit të tyre në klasë. Komentojnë komunikimin e tyre me bashkëmoshatarët dhe me mësuesin. Vihet në pah dallimi në mes dialogut me shokun ose shogën dhe me mësuesin apo dikë më të moshuar. Përveç komunikimit të tillë nxënësit emërtojnë edhe mënyra të tjera të komunikimit nëpërmjet telefonit, e-mailit, letrave etj. Nxënësit kuptojnë që letrat janë një nga mënyrat me anë të së cilës mund të komunikojnë.

Realizim kuptimi:

Në tekstin e dhënë të tekstit mësimor, nxënësit vërejnë dallimet në mes dialogut, i cili zhvillohet në mes bashkëmoshatarëve dhe mësueses me nxënësit. Në mënyrë të njëjtë analizojnë dhe diskutojnë për letrat e dhëna. Me anë të projektorit paraqiten letrat nga teksti mësimor drejtuar kryetarit të bashkësisë, mësueses dhe shoqes. Analizohen përmbajtjet e letrave, duke veçuar elementet e tyre. Diskutohet përmbajtja e letrës shkruar kryetarit të bashkësisë dhe letra shkruar shoqes.

Lexohen informacionet rreth letrës zyrtare dhe jozyrtare.

Letra jozyrtare i shkruhet një njeriu të afërt dhe fillon me fjalët *I dashur/e dashur* dhe mbyllet me fjalët *me dashuri, për qafime, për zemërsisht*. Këto letra kanë mjaft shprehje emocionale.

Letra zyrtare i drejtohet një njeriu ose një institucioni që mbajnë logon e tyre. Drejtohem i me *I nderuar / e nderuar* duke i dhënë stil zyrtar. Paraqiten me kujdes të gjitha pjesët e letrës të cilat duhet ta përbëjnë atë. Emrin, kujt i drejtohet, përshëndetjen, përshkrimin, kush e shkruan, datën.

Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë nga dy letra të shkurtra, një për vëllain, i cili studion jashtë qytetit ose shtetit, ndërsa tjetrën për drejtorin e shkollës, duke sqaruar pse nuk merr pjesë në një aktivitet.

Letra plotësohet me elementet që duhet të përmbajë dhe përgatitet zarfi më të dhënat e dërguesit, marrësit, datës dhe adresës.

Ushtrimi 3 dhe 4

Diskutohet me nxënësit për pohimet e dhëna, duke arsyetuar nëse ato janë të sakta apo të gabuara.

Punë me fletore pune.

Nxënësit lexojnë dhe vërejnë letrat e dhëna, duke përcaktuar llojin e tyre dhe duke vërejtur plotësuar ato që mungojnë, në mënyrë që letra të jetë e shkruar drejt.

Reflektim.

Luajmë dhe mësojmë. Nxënësit gjejnë fjalët: ***adresa, letra, kartolina, urime, personale, zyrtare në mes shkronjave të dhëna.***

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 5

Festa, urime dhe ftesa

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të diskutojë me shokët për urimet që ata kanë dërguar;
- Të shkruajë urime zyrtare dhe jozyrtare;
- Të dallojë ftesën zyrtare dhe jozyrtare.
- Të shkruajë urime dhe ftesa.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: ftesë, urim, festë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Organizohet një festë në klasë. Nxënësit ftohen të sjellin disa ushqime që u pëlqejnë dhe përcaktohet një ditë si festa e klasës. Së bashku me nxënësit formohet kalendari i ditëlindjeve. Diskutohet për festimin e ditëlindjes së tyre.

Ku kanë festuar?

Me kë kanë festuar?

Cila ishte dhurata më e bukur?

Cili ishte urimi më i bukur?

Emërtojnë festa të tjera të cilat festohen në familje dhe në vendin e tyre duke veçuar festat që u pëlqejnë më shumë.

Realizim kuptimi.

Lexojnë në tekstin për festën e Vitit të Ri. Kujtojnë kartolinat, në mesazhet e urimit, që dërgojnë dhe marrin zakonisht.

Lexohet dhe diskutohet teksti i dhënë në tekstin mësimor, analizohet përmbajtja.

Ushtrimi 1.

Nxënësit kujtojnë datat e festave që u pëlqejnë më shumë dhe shkruajnë nga një urim për to.

Kuptojnë që urimet si shprehje e dëshirave tona të mira për dikë, zakonisht me rastin e ndonjë feste. Ato mund të bëhen për festa të ndryshme. Urimet mund të bëhen me shkrim dhe me gojë. Urimet me shkrim duhet të përmbajnë: vendin dhe datën e dërgimit, emrin e marrësit, përmbajtjen dhe nënshkrimin e dërguesit.

Ushtrimi 2

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë një ftesë për shokun/shoqen dhe për mësuesin me rastin e ditëlindjes së tyre. Kujtojnë që ftesa mund të jetë jozyrtare dhe u dërgohet zakonisht miqve dhe të njohurve me rastin e ndonjë ngjarje personale) dhe zyrtare (u dërgohet edhe personave që nuk i njohim, zakonisht për ngjarje publike)

Ushtrimi 4 punohet në mënyrë të pavarur.

Reflektim.

Punë në fletore pune.

Ushtrimi 2.

Përshkruajnë dhuratën e dëshiruar të ditëlindjes dhe urimin më të bukur për atë ditë.

Ushtrimi 3.

Mendohen tri dëshira për shokun/ shoqen dhe shkruhet secila në formën e urimit. Nxënësit i ndërrojnë librat dhe lexojnë urimet e njëri-tjetrit.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 6

Lajmërime publike. Të shkruajmë saktë datën

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë tekstet letrare nga joletrare
- Të kuptojë çfarë janë njoftimet publike.
- Të përgjigjet me gojë dhe me shkrim në pyetjet mbi përmbajtjen e tekstit.

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, punë në grup.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: lajmërim, datë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Me nxënësit organizohet ekspozita e vizatimeve të tyre në korridorin e shkollës. Përgatitet lajmërimi, i cili do të jetë për të gjithë nxënësit e shkollës, ku do të njoftohen për kohën, datën, vendin dhe mënyrën e organizimit.

Realizim kuptimi:

Nga teksti mësimor lexojnë dhe kuptojnë çfarë është lajmërimi dhe mësojnë shkrimin e drejtë të lajmërimeve duke përfshirë të gjitha detajet e nevojshme. Ndalen në veçanti tek shkrimi i datave në mënyrë të duhur.

Ushtrimi 1. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Ushtrimi 2. Nga njohuritë e fituara me lart, përcaktojnë shkrimin e drejtë të datave.

Nxënësit lexojnë tekstin "Gjyshërit na rrëfejnë" duke përshkruar përmbajtjen dhe duke e lidhur me vetë jetën e tyre dhe atë çfarë kanë mësuar nga më të moshuarit.

Nxënësit në grup përgatisin një njoftim për projektin "Gjyshërit na rrëfejnë."

Reflektim.

Punë në fletore pune.

Ushtrimi 1. Plotësojnë fjalitë me fjalët që mungojnë në mënyrë që të krijojnë një njoftim të drejtorisë. Kuptojnë që njoftime të tilla mund të shkruhen për raste të ndryshme.

Ushtrimi 2. U përgjigjen pyetjeve të dhëna, duke diskutuar mbi ndikimin e reklamave, për blerjen e ndonjë produkti ose sendi tjetër që nxënësit kanë blerë nën ndikimin e reklamave. Diskutohet për tabelat e njoftimeve për transporte publike - të trenave, autobusëve, aeroplanëve dhe arsyen pse këto njoftime duhet të jenë publike, në çfarë mënyre ato u lehtësojnë jetën qytetarëve.

Ushtrimi 3. Plotësojnë njoftimet, duke dhënë përgjigjen e saktë.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në teksti mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 7

Të shkruash një biografi dhe një autobiografi

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë biografinë nga autobiografia.
- Të jetë i aftë të shkruajë një autobiografi të shkurtër.

Metodat dhe teknikat: bisedë, demonstrim

Korrelacion: letërsi, njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: përshkruajmë, biografi, autobiografi.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës.

Evokim

Secili nxënës merr një fletë të bardhë në të cilën përshkruan veten dhe jetën e tij, duke përshkruar të gjitha detajet nga e kaluara. Pas përfundimit të detyrës, ndërrojnë fletoret me shokun e bankës dhe në bazë të të dhënave, të cilat nxënësi ka shkruar për veten e tij, shoku do të krijojë një biografi për shokun, duke filluar me emrin dhe mbiemrin e tij, datën e lindjes, fillimin e shkollimit etj.

Lexohen dhe diskutohet për biografitë e dhëna në tekstin mësimor.

Realizim kuptimi.

Hapen tekstet dhe lexohet biografia e Anton Goçajt. Atëherë mësuesja sqaron se shkrimi biografik është një tekst përshkruues që tregon jetën e një njeriu. Për këtë arsye, ai shkruhet në vetën e tretë. Biografinë nuk e shkruan vetë, por e shkruan dikush, duke përshkruar çfarë ka ndodhur në jetën e një personaliteti, ndaj edhe veprimet tregohen në të shkuarën.

Në biografi rendisim datat në të cilat kanë ndodhur ngjarja e rëndësishme për atë person. Po ashtu, përmendim vendet ku ka qenë, ashtu si edhe shkollat që ka kryer, punët që ka zhvilluar.

Ushtrimi 1. Udhëzohen të shkruajnë një autobiografi për Nënë Terezën.

Ushtrimi 2. Plotësohet fjalëkryqi me fjalët (*Shkup, Nobel, Gonxhe, Gusht, Humaniste, Kalkuta*).

Punë me fletore pune

Nxënësit kujtojnë se çfarë nënkupton autobiografia dhe me ndihmën e pyetjeve të dhëna shkruajnë një autobiografi.

Kur ke lindur? _____

Ku ke lindur? _____

Sa vëllezër e motra ke?

Me kë jeton?

Ku ke shkuar në kopsht?

Në cilën shkollë je?

Sa vjeç e ke filluar shkollën? _____

Cili është kujtimi më i bukur i kohës kur ke qenë më i vogël? _____

Me çfarë të pëlqen të merresh? _____

Çfarë do të bëhesh kur të rritesh? _____

Ushtrimi 2 punohet në mënyrë të pavarur.

Ushtrimi 3. Diskutojnë për kopertinat e librave dhe në bazë të kopertinës dhe asaj që është shkruar në to, tregojnë nëse bëhet fjalë për biografi apo autobiografi?

Reflektim:

Udhëzohen dhe grumbullojnë informacione për të shkruar biografi të shkurtër të ndonjë shkrimtari të vendit ose të huaj.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

PJESA E DYTË

Mësimi 8

Emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm. Përdorimi i shkronjës së madhe. Emrat konkretë dhe emrat abstraktë

Arritjet e të nxënës:

Janë në gjendje:

- Të dallojnë emrat e përgjithshëm nga emrat e përveçëm.
- Të dallojnë emrat konkretë nga emrat abstraktë.
- Të përdorin saktë shenjat e pikësimit.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: emër, konkret, abstrakt, i përgjithshëm, i përveçëm.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Mësuesja ka përgatitur disa emra të ndryshëm dhe i projekton në tabelë. I fton nxënësit të dallojnë secilin prej tyre. Çfarë pjese e ligjëratës janë? Çfarë kujtoni nga klasa e katërt?

Realizim kuptimi.

Mësuesja sqaron: Emrat e përgjithshëm emërtojnë njerëz, kafshë, sende, vende, dukuri etj., pa i dalluar nga të tjerët: *djalë, vajzë, qen, ujk, qytet, mal, shi, furtunë* etj.

Emrat e përveçëm janë ata që emërtojnë njerëz, kafshë, sende, vende, dukuri etj., duke i dalluar nga të tjerët: *Rei, Gea, Bardhosh, Podgoricë, Rumia, Tara* etj.

Plotësohet tabela së bashku me mësuesen.

Në vijim mësuesja tërheq vëmendjen se emrat që emërtojnë diçka që mund të perceptohet me anë të shqisave, që mund të preken, që mund t'i ndiejmë me nuhatje, që mund t'i dëgjojmë, t'i shijojmë, t'i vizatojmë, quhen emra konkretë, si p. sh. : libër, mace, shok, makinë, flutur, lumë, ëmbëlsi, këngë etj.

Emrat që emërtojnë diçka nga nuk perceptohet me anë të shqisave e s'mund të vizatohet, quhen emra abstraktë, si p. sh. : mendim, dashuri, trishtim, muaj, festë, vit etj.

Punohet ushtrimi nga kërkon që nxënësit të bëjnë një përshkrim. Orientohen si do të punojnë. Punohet Ushtrimi 2 ku do të korrigjohen gabimet në tekst. Diskutohet rreth tyre.

Reflektim.

Punohet në fletore pune. Punohet ushtrimi 1 ku nxënësit duhet të zgjedhin alternativën e saktë. Argumentohet zgjedhja. Kalohet në ushtrimin 2 ku nxënësit duhet të gjejnë përkatësinë e emrave të nënvizuar.

Diskutohen në klasë. Vlerësohen përgjigjet.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 9

Gjinia dhe numri i emrit

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë gjininë e emrave.
- Të përdorë drejt emrat në numrin shumës.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë e pavarur, krijim i drejtuar.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjale kyçe: gjini femërore, gjini mashkullore

Mjetet e Mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Mësuesja paraqet fjalitë:

*Edhe vetë **zonja** Lindman për një **moment** u duk sikur kishte gëlltitur **gjuhën**. Më pas shënoi në **regjistrin** e saj të kuq.*

*– Epo Koni, katër atëherë! Do të kesh mundësi ta përmirësosh, – tha ajo me një **qetësi** të pabesueshme.*

*– Katër? – ia bëri Koni dhe **sytë** iu mbushën me **lot**.*

Vëmendja përqendrohet tek fjalët me të zeza. Bëhet krahasimi në mes tyre. Cilët emra mund t'i çojmë në numrin shumës? Ndalemi tek dallimet.

Realizim kuptimi.

Kalohet tek teksti i plotë. Krahasohen emrat dhe vihen re ndryshimet. Mësuesja tërheq vëmendjen se disa emra në numrin shumës kalojnë në gjininë femërore, p. sh. *qytet i madh - qytete të mëdha; fshat malor - fshatra malore.*

Punohet Ushtrimi 1 ku u kërkohet nxënësve të gjejnë gjininë e emrave të dhënë. Kalohet tek ushtrimi 2 ku nxënësit do të gjejnë emrin e kafshës në figurë. Punohet ushtrimi 3 dhe 4.

Reflektim.

Punohet në Fletore pune. Ushtrimi 1 kërkon që nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve. Ushtrimi 2 kërkon që të ndryshohet gjinia e fjalëve në fjalitë e mëposhtme. Punohet ushtrimi 3 dhe 4. Diskutohen në klasë. Analizohet ora e mësimi.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 10

Parafjalët

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë parafjalët sipas rasave.
- Të arrijë të dallojë fjalët që drejtojnë parafjalët.

Metodat dhe teknikat: shpjegim, punë e drejtuar, punë e pavarur, krijim i drejtuar.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjale kyçe: rasë, parafjalë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Paraqiten në tabelë grupet e fjalëve: *në shtëpi, nga shtëpia, prej shtëpisë*. Në cilën rasë janë emrat? A ju ndihmoi ndonjë element për të gjetur rasën e tyre?

Realizim kuptimi.

Lexohet teksti dhe përqendrohet vëmendja tek fjalët me të zeza. Gjenden fjalët pas tyre, përcaktohet pjesa e ligjëratës.

Mësuesi sqaron:

Fjalët me të zeza janë parafjalë. Ato qëndrojnë para emrave dhe përemrave dhe i drejtojnë këta në një rasë të caktuar.

Parafjalët shfaqen në katër rase të sistemit të lakimit në shqipe:

Rasa	Parafjalët
emërore	<i>te (tek), nga</i>
gjinore	<i>me anë, në vend, për nder, në mes etj.</i>
kallëzore	<i>me, në, mbi, nën, për etj.</i>
rrjedhore	<i>afër, pas. para. prej, pas etj.</i>

Punohet ushtrimi 1 bashkë me mësuesin. I kushtohet kujdes vendosjes së drejtë të parafjalës.

Punohet ushtrimi 2 dhe 3 që kërkon identifikimin e rasës së secilës prej parafjalëve.

Reflektim

Punohet në Fletore pune. Nxënësit plotësojnë tabelën duke vendosur përkrah rasës, parafjalën që duhet. Punohet ushtrimi 2 që kërkon të vendoset parafjala e duhur në vendet bosh.

Në vazhdim punohet ushtrimi 3 dhe 4. Diskutohen në klasë.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në teksti mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 11

Lakimi i emrave. Emra të lakimit të parë dhe të dytë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë emrat në fjali. Lakon emrat që hyjnë në lakimin e parë dhe të dytë;
- Të vendosë në rasën e duhur emrat në fjali;
- Të bëjë analizën morfologjike të emrave;
- Të krijojë fjali me emra që u përkasin dy lakimeve të para;
- Të krijojë fjali me emra që i përkasin lakimit të parë dhe të dytë.

Metodat dhe teknikat: Përvijim i të menduarit, të nxënit në bashkëpunim, punë individuale, zbatim i njohurive të marra.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: emër, lakim, rasë, lakim i parë, i dytë, pyetje, analizë morfologjike.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Përvijim i të menduarit

Mësuesja paraqet në tabelë fjalinë: Miu kishte gabuar që i ishte afruar djalit. Ndalen tek emrat miu, djali. Tërhiqet vëmendja për gjininë e tyre dhe mbaresat.

Realizim kuptimi.

Mësuesja projekton paradigmen e lakimit të një emrit të lakimit të parë dhe të dytë.

Sqaron se:

Lakimi I - emra të gjinisë mashkullore, që në trajtën e shquar mbarojnë me -i: syri, libri.

Lakimi II - emra të gjinisë mashkullore, që në trajtën e shquar mbarojnë me -u: krah, miku.

Lakimi III - emra të gjinisë femërore, që në trajtën e shquar mbarojnë me -a / -ja: lulja, dera.

Lakimi IV - emra të gjinisë asnjëse, që në trajtën e shquar mbarojnë me -t/-ët/- të: të ecurit, të ftohtët.

Diskutohen ndryshimet që i ndodhin emrit gjatë lakimit.

Punohet Ushtrimi 1. Orientohen nxënësit se si do ta plotësojnë tabelën. Punohet ushtrimi 2 që kërkon që nxënësit të lexojnë pjesën dhe të nënvizojnë emrat dhe t'i analizojnë. Plotësohet fjalëkryqi i ushtrimit 3.

Reflektim.

Punohet në fletore pune ushtrimi 1 që kërkon që nxënësit të plotësojnë vendet bosh me emrat e duhur. Punohet ushtrimi 2 dhe plotësohet fjalëkryqi i ushtrimit nr. 3.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 12

Emrat e lakimit të tretë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- dallon emrat në fjali. Lakon emrat që hyjnë në lakimin e tretë;
- vendos në rasën e duhur emrat në fjali;
- bën analizë morfologjike të emrave;
- krijon fjali me emra që u përkasin tri lakimeve të para;
- krijon fjali me emra që i përkasin lakimit të tretë.

Metodat dhe teknikat: Përvijim i të menduarit, të nxënit në bashkëpunim, punë individuale, zbatim i njohurive të marra.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: emër, lakim, rasë, lakim i tretë, parafjalë, pyetje, analizë morfologjike.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Përvijim i të menduarit

Mësuesja paraqet në tabelë fjalinë: Çdo ditë anijet dilnin për peshkim. Nxënësit lakojnë emrat ditë dhe anijet në trajtën e shquar, numri njëjës.

Veçohet rasia emërore e secilit emër.

dit - a	}	→	emra të gjinisë femërore, mbarojnë me -a-, -ja .
ani - ja		→	i përkasin lakimit të tretë
peshkim - i		→	emër i gjinisë mashkullore, mbaron me -i , lakimi i parë

Realizim kuptimi.

Të nxënësit në bashkëpunim

Nxënësit hapin librin në faqen 47. Lexojnë lakimin e emrit **zemra** dhe rregullën gjuhësore.

Tërhiqet vëmendja për disa emra të gjinisë mashkullore që shënojnë frymorë, të tillë si: dajë, axhë, fëmijë etj., të cilët lakohen si emra të lakimit të tretë.

Punohet rubrika "Ushtrohu".

Në ushtrimin 1 nxënësit do të nënvizojnë emrat e lakimit të tretë

Rikujtojnë: shoqëri - shoqëria, racë - raca, fe - feja.

Në ushtrimin 2 nxënësit do të plotësojnë tabelat me lakimet e emrave derë dhe ide, në numrin njëjës dhe shumës, trajta e pashquar dhe e shquar.

Reflektim.

Zbatimi i njohurive të marra

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 13

Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- dallon mbiemrat në fjalitë e dhëna;
- identifikon nyjat në mbiemrat e nyjshëm;
- shoqëron emrat e dhënë me mbiemra, duke i përshtatur në gjini dhe numër me emrat;
- plotëson mbiemrat me nyjë ose mbaresë sipas gjinisë e numrit.

Metodat dhe teknikat: Lexim i drejtuar, të nxënë në bashkëpunim, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: mbiemra, nyja, të nyjshëm, mbaresë.

Mjetet e mësim: teksti mësimor, format A4, lapsa me ngjyra

Evokim.

Lexim i drejtuar

Mësuesi/ja lexon bashkë me nxënësit mbiemrat. Shkruan në tabelë disa nga mbiemrat: i mardhur, të thatë, vjeshtarak, perëndimor...

Nxënësit rikujtojnë ç'dinë për mbiemrat.

Realizim kuptimi.

Të nxënë në bashkëpunim

Punohet materiali i dhënë. Nënvizojnë te vjersha të gjithë mbiemrat. Tërhiqet vëmendja te nyjat që marrin mbiemrat e nyjshëm.

i, të, → gjinia mashkullore (peshk **i kuq**, peshq **të kuq**)

e, të → gjinia femërore (lule **e bukur**, lule **të bukura**)

Punohet rubrika "Ushtrohu".

Në **ushtrimin 1** nxënësit do të nënvizojnë mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm.

Të nyjshëm: i kaltër, të largëta, të panjohura, e larta, e egra, e buta, të egra, e madhe.

Të panyjshëm: krahëshpejtë, shtegtarë, bardhosh.

Në ushtrimin 2 nxënësit do të shoqërojnë emrat e dhënë me nga një mbiemër, duke i përshtatur në gjini dhe numër nxënës shembullor, mal i lartë, dhëlpër dinake, këngëtar i ri, kodër e ulët, ujk grabitqar

Në ushtrimin 3 nxënësit do të plotësojnë me nyjë ose mbaresë mbiemrat e dhënë.

grua e vjetër, pallto e gjatë, pantallona të kaltra, kapelë e ngrohtë, djalë i vogël, flokë të kuq, këpucë të mëdha,

Reflektim.

Punë individuale

Mësuesi/ja ndan nxënësit në dy grupe. Analizojnë nga ana morfologjike mbiemrat që kanë

nënvizuar në ushtrimin 1. (Në varësi të kohës, mësuesi/ja mund t'i ndajë nxënësit në dy grupe, ku secili grup do të analizojë gjysmën e mbiemrave.)

p. sh. : i kaltër — mbiemër, i nyjshëm, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa emërore. kra-hëshpejtë — mbiemër, i panyjshëm, gjinia mashkullore, numri shumës, rasa kallëzore.

Diskutohet puna e bërë, argumentohen përgjigjet.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 14

Shkallët e mbiemrit

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Njeh shkallët e mbiemrit.
- Arrin që të vendosë një mbiemër në shkallë të ndryshme.

Metodat dhe teknikat: Përvijim i të menduarit, të nxënit në bashkëpunim, punë individuale, zbatim i njohurive të marra

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: mbiemër, shkalla pohore, shkalla krahasore, shkalla sipërore.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Projekton një fotografi ku është një lule. I fton nxënësit që të japin sa më shumë tipare të saj me anë të mbiemrave të ndryshëm.

Realizim kuptimi.

Lexohet poezia. Nënvizohen mbiemrat. Vihen re ndryshimet në mes tyre. Krahasohen.

Mësuesja sqaron:

Shkalla pohore

Mbiemri në shkallën pohore tregon një cilësi të emrit, pa e krahasuar atë me një qenie apo send tjetër: shtëpi e re, autobus i shpejtë, libër interesant.

Mbiemri në shkallën krahasore tregon një cilësi të emrit, duke e krahasuar me një cilësi të dikujt tjetër apo me veten: Ky libër është po aq interesant sa ai tjetri. Kjo është më e bukur, se e dobishme.

Në shkallën sipërore mbiemri tregon një cilësi në shkallë shumë të lartë, pa e krahasuar atë: ishte shumë e zgjuar, kishte një zë jashtëzakonisht melodioz.

Punohet Ushtrimi 1 që kërkon të gjendet shkalla e mbiemrave. Punohet bashkë me mësuesin.

Punohet në grup ushtrimi 2 që kërkon plotësimin e vendeve bosh me mbiemrat e duhur.

Analizohen mbiemrat në ushtimin nr. 4

Reflektim.

Punohet Ushtrimi 1 në fletoren e punës që kërkon zgjedhjen e alternativës së saktë. Kërkohet argumentim i përgjigjes. Punohet ushtrimi 2 që ka të bëjë me shkallën e saktë të mbiemrave.

Punohet Ushtrimi 3 ku nxënësit do t'i kalojnë në shkallën sipërore mbiemrat e dhënë.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 15

Lakimi i përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra

Arritjet e të nxënit: Është në gjendje:

- dallon përemrat vetorë;
- lakon përemrat vetorë;
- dallon rasën e përemrave vetorë dhe vendos trajtën e shkurtër që duhet;
- shkruan saktë përemrat vetorë.

Metodat dhe teknikat: Diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: mbiemra, nyja, të nyjshëm, mbaresë.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabela e lakimit të përemrave vetorë, format A4, fletore, lapsa.

Evokim.

Diskutim i ideve

Mësuesi/ja shkruan tekstin e dhënë.

Nxënësit do të nënvizojnë përemrat vetorë duke përdorur pyetjet sipas rasave.

Kë? – ne; kujt? – mua; kush? – ne; kujt? – neve; kujt? – mua.

Realizim kuptimi.

Punë e drejtuar. Punohet materiali gjuhësor i dhënë në tekst.

Nxënësit e vërtetojnë ndryshimet që pësojnë përemrat vetorë kur përdoren në fjali. Gjithashtu vënë re: **më, na, të, ju, i, e, u** të cilat zakonisht qëndrojnë para foljeve dhe shoqërojnë emrat në rasën kallëzore dhe dhanore. Këto janë trajtat e shkurtra. Nxënësit lexojnë në tekst tabelën e lakimit të përemrave vetorë.

Rrethojnë me laps trajtat e shkurtra, tregojnë në cilat rase ato shoqërojnë emrat.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve për përemrat e vetës së parë dhe të dytë - mund të mos jenë të pranishëm në fjali, vetëm në rastet kur ne duam t'i theksojmë ata janë të pranishëm. Lexohen shembujt në tekst.

Kalohet në rubrikën Ushtrohu.

Në ushtrimin 1 nxënësit do të nënvizojnë me të kuqe përemrat dhe me blu trajtat e shkurtra.

Përemrat vetorë	Trajtat e shkurtra
Ai, ajo, ajo, unë, ajo, ti, ty, ajo, ti, asaj	i, e, më, e, e, i, të, i, i

Reflektim.

Punë individuale Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalitë.

Nxënësit do të nënvizojnë përemrat vetorë me të kuqe dhe trajtat e shkurtra me blu. Bëjnë

analizën e tyre.

Atë e morën në olimpiadën e matematikës. **Neve na** pëlqen shumë lënda e historisë. **Ne na** zgjodhën ndër më të mirët.

Juve nuk **ju** pëlqejnë perimet?

Vlerësohet puna e nxënësve.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 16

Fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë fjalët e parme;
- Të dallojë fjalët e prejardhura;
- Të dallojë fjalët e përbëra.

Metodat dhe teknikat: Diskutim i ideve, shpjegim, punë e drejtuar, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: e parme, e prejardhur, e përbërë mbaresë.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, format A4, fletore, lapsa projektor.

Evokim.

Diskutim i ideve

Mësuesi/ja projekton poezinë e dhënë. Ndalet në veçanti tek fjalët me të zeza. I fton nxënësit që t'i krahasojnë ato me fjalët e tjera. i pyet: Çfarë vini re? Ku ndryshojnë?

Pastaj dilet në përfundimin se fjala bletushe vjen nga bletë + ushe.

Fjala në mesditë mund të ndahet në dy fjalë të tjera: në mes + ditë.

Realizim kuptimi.

Mësuesja përnjë mes shembujve të mësipërm dhe shembujve të tjerë sqaron se:

Fjala bletë është e parme, sepse nuk vjen nga një fjalë tjetër.

Fjala bletushe është e prejardhur, sepse vjen nga bletë + ushe (një prapashtesë)

Fjala mesditë është e përbërë, sepse vjen nga dy fjalë të tjera: në mes + ditë

Fjalët e prejardhura formohen me parashtesa ose prapashtesa, p. sh. :

Me parashtesa: pa+barazi. sh+këmbe, për+cakto;

Me prapashtesa: pun + o, angl + isht, gjum + ash;

Me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht: z+bukur+o, për + fund +o.

Fjalët e përbëra formohen nga dy ose më shumë tema: zemër + mirë, mirë + pres, krye + qytet.

Tërhiqet vëmendja se si duhet të dallohet secili prej tri grupeve të fjalëve të përmendura më lart.

Kalohet në rubrikën **Ushtrihu**.

Punohet Ushtrimi 1 i cili kërkon të dallohen fjalët e parme nga jo të parmet në tekstin e dhënë. Punohet së bashku me mësuesen.

Kështu veprohet edhe me Ushtrimin 2. Diskutohet zgjedhja e alternativës dhe kërkohet argumentimi i përgjigjes.

Reflektim.

Punë individuale Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalët: **lexo, dëgjo, letër, dritë, fjalë** dhe kërkon nga nxënësit që të krijojnë prej tyre fjalë të prejardhura. Diskutohen fjalët e krijuara.

Vlerësohet puna e nxënësve.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 17

Folja dhe zgjedhimi i saj

Arritjet e të nxënit:

Nxënësi/ja është në gjendje:

- të dallojë foljet e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë;
- të klasifikojë foljet sipas zgjedhimit;
- të vlerësojë punën e shokëve e të shoqeve;
- të demonstrojë besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- të bashkëpunojë në grup për kryerjen e detyrave.

Metodat dhe teknikat: analizë; dallo-trego; diskutim; shkëmbe një problemë; punë individuale, punë në çift, punë me gjithë klasën, punë në grup.

Korrelacion: Shoqëria dhe mjedisi; Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: zgjedhimi I, II, III; foljet që mbarojnë me -j, me bashkëtingëllore, me zanore; koha e tashme; koha e pakryer; koha e kryer të thjeshtë; koha e ardhme.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelat e zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë; mjete shkrimi, lapsa me ngjyra, fletore, fletë A4.

Evokim:

Njihen nxënësit/et me temën e mësimi.

Zhvillohet një përsëritje e shpejtë e kohëve të foljes që janë mësuar në mësimet e kaluara.

Nxiten nxënësit/et të shikojnë me kujdes foljet me të zeza.

Udhëzohen nxënësit që foljet me të zeza t'i vendosin në tabelën përkatëse sipas kohëve të duhura.

Lexohen foljet nga nxënësit dhe diskutohen me të gjithë klasën.

Realizim kuptimi

U jepen nxënësve njohuritë e reja të mësimi.

Foljet i ndajmë në tri zgjedhime, nisur nga mbaresat që marrin në kohën e tashme, veta e parë, numri njëjës:

Zgjedhimi i parë → foljet që mbarojnë me -j: mësoj, gjej, shkruaj, mendoj etj.

Zgjedhimi i dytë → foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore: mbledh, qesh, pjek, hedh etj.

Zgjedhimi i tretë → foljet që mbarojnë me zanore: fle, vë, zë, di, rri etj.

Dallo-trego: Ushtrimi 1 synon që nxënësit/et të tregojnë rregullin e klasifikimit të foljeve sipas zgjedhimit dhe të gjejnë nga tri folje për secilin rast.

Diskutim: Punë në grupe: Ndahet klasa në tri grupe. Secili grup plotëson tabelën me foljet e dhëna (ushtrimi 2) Në ushtrimin 3 nxënësit përsëri në grupe gjejnë foljet, i kthejnë në kohën e tashme, veta e parë, numri njëjës dhe tregojnë se cilit zgjedhim i përket folja në fjalë.

Diskutohen ushtrimet dhe zgjidhja e tyre.

Ushtrimi 5 synon që nxënësit të gjejnë foljet në tekstin e dhënë dhe të gjejnë **kohën, vetën dhe numrin për secilën.**

Shkëmbe një problemë: Punë në grupe:

Reflektim.

Hapein fletoret e punës.

Udhëzohen nxënësit që të punojnë me shokun e bankës ushtrimin 1 dhe 3. Ushtrim 1 synon përforcimin e njohurive, kurse ushtrimi 3 synon që nëpërmjet lojës të gjejnë fjalëkryqin me folje. Në fund të orës bëhet shkëmbimi i librave dhe nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.

Vlerësimi bëhet për:

- dallimin e foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë;
- klasifikimin e foljeve sipas zgjedhimit;
- klasifikimin e foljeve të zgjedhimit të parë, të dytë, të tretë në kohën e tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë, të ardhme;
- vlerësimin e punës së shokëve e të shoqeve.

Detyrë:

Ushtrimi 2 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi18

Kohët e thjeshta të foljeve në mënyrën dëftore

Arritjet e të nxënit:

Nxënësi/ja është në gjendje:

- dallon foljet e dhëna në fjali;
- dallon kohën e thjeshta të mënyrës dëftore;
- klasifikon foljet e mënyrës dëftore sipas kohës, vetës dhe numrit;
- krijon një tekst duke përdorur kohët e thjeshta të mënyrës dëftore.

Metodat dhe teknikat: Vëzhgo - dallo, kllaster, diskutim, punë e drejtuar, krijim i drejtuar.

Korrelacion: Shoqëria dhe mjedisi; Kultura e artit figurativ.

Fjalë kyçe: mënyra dëftore, kohët e thjeshta, e tashme, e shkuar, e ardhme.

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, flipçart me kohët e thjeshta të foljes, fisha me folje në mënyrën dëftore

Evokim:

Paraqiten fisha me fjalë që tregojnë veprime.

Si emërtohen këto fjalë? Pse quhen folje?

Kujtojmë zgjedhimet e foljes. Pyeten 2-3 nxënës

Shkruaj në tabelë:

Në çfarë kohe mund të ndodhin veprimet?

Këtë e paraqesim nëpërmjet kohëve të ndryshme të foljes.

Kohët e thjeshta të mënyrës dëftore:

Koha e tashme: **Ti reciton me pasion. / Ti po reciton me pasion.**

Koha e shkuar: - Koha e pakryer: **Ai fliste me zë të ulët. / Ai po fliste me zë të ulët.**

Veprimi ka zgjatur ose nuk ka përfunduar në të shkuarën.

- Koha e kryer e thjeshtë: **Ajo ujiti lulet.**

Veprimi ka përfunduar në të shkuarën.

Koha e ardhme: **Unë do të vij më këmbë.**

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë në heshtje tabelat me foljet e zgjedhuara sipas zgjedhimit të parë, dytë e tretë. Shikohet me kujdes zgjedhimi i foljeve *gëzoj, lëviz, pi* në të gjitha kohët e thjeshta të mënyrës dëftore.

Lexohen zgjedhimet me zë nga nxënësit.

Ushtrimi 1 synon që nxënësit të rikujtojnë njohuritë e marra nga mësimet e mëparshme

Ushtrim 2 synon që nxënësit të lidhin foljet me kohën e duhur.

Ushtrimi 3 punohet në grupe me nga 4 nxënës. Nxënësit do të vendosin foljet e dhëna në kohën, vetën dhe numrin e dhënë. Pasi e përfundojnë ushtrimin, shkëmbejnë librat me grupin tjetër dhe diskutojnë për zgjidhjen e tyre. Shkruhen në tabelë zgjidhjet e



duhura.

Ushtrimi 4 punohet individualisht. Nxënësit do të gjejnë foljet në fjalitë e dhëna dhe do të tregojnë se në cilën vetë, kohë dhe numër janë.

Ushtrimi 5 realizohet me shokun e bankës në formën e një loje. Nxënësit punojnë sipas kërkesës me fjalëkryqin.

Udhëzohen nxënësit që të punojnë individualisht në fletoren e punës.

Ushtrimi 1, nxënësi plotëson vendet bosh me folje në formën e duhur.

Ushtrimi 2 vendosin foljet në kohën e kryer të thjeshtë.

Ushtrimi 3 vendosin foljet në kohën e pakryer ose të ardhme

Kontrollohen dhe diskutohen ushtrimet e zgjidhura nga nxënësit.

Shkruhen në tabelë ushtrimet ku nxënësit kanë shfaqur paqartësi.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për:

- dallimin e foljeve të kohëve të thjeshta të mënyrës dëftore;
- klasifikimin e foljeve sipas kohës, vetës dhe numrit;
- krijimin e një teksti duke përdorur folje në kohë të ndryshme.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Detyrë: Ushtrimi 4 fletore pune - **Shkruani nga një fjali në lidhje me ditën e djeshme, të sotme dhe të nesërme. Kujdes kohën e foljeve.**

Mësimi 19

Zgjedhimi i disa foljeve, si: *jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha*

Arritjet e të nxënit:

Nxënësi/ja: është në gjendje:

- të zgjedhë foljet *jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha* në kohët e thjeshta të mënyrës dëftore.
- të dallojë kohën, vetën dhe numrin e foljes së dhënë.
- të dallojë foljet që janë shkruar gabim dhe i korrigjon ato.
- të krijojë fjali duke përdorur foljet *marr, dal, jap, shoh* në veta dhe numra të ndryshëm.

Metodat dhe teknikat: Harta e foljes, punë e drejtuar, punë e pavarur, shkëmbe një problemë.

Korrelacion: Shoqëria dhe mjedisi; Kulture e artit figurativ.

Fjalë kyçe: foljet *jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha*; mënyra dëftore, kohët e thjeshta, e tashme, e shkuar, e ardhme.

Mjetet e mësim: teksti mësimor, fisha me folje të zgjedhimit të dytë, flipçarte me zgjedhimin e foljeve.

Evokim:

Paraqiten fisha me folje të zgjedhimit të dytë: *dal, marr, jap, shoh*.

U paraqiten nxënësve fisha me folje në kohën që janë dhe numra të ndryshëm.

Gjeni kohën, vetën, numrin e tyre.

Realizim kuptimi.

Paraqiten në fisha foljet: *jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha*.

Si mund të zgjedhohen këto folje në kohën e pakryer? Po në kohën e kryer të thjeshtë apo të ardhmen? Si thoni ju, si do të ndryshojnë formë ato?

Janë disa folje të cilat në kohë të veçanta nuk marrin vetëm mbaresë, por ndryshojnë përbërjen e fjalës.

Udhëzohen nxënësit që të shikojnë me kujdes tabelat me zgjedhimet e dhëna në tekst. Vihet theksi tek ndryshimi që pësojnë këto folje në kohë të ndryshme. Nxiten nxënësit që t'i lexojnë në heshtje tabelat e dhëna.

Pasi i lexojnë në heshtje bëhet leximi zinxhir me zë të lartë.

Punë me tekstin

Udhëzohen nxënësit që të punojnë ushtrimet me radhë.

Ndahet klasa me grupe me nga 4 nxënës.

- Ushtrimi 1 dhe 2 zhvillohet në grup ku nxënësit do të plotësojnë së bashkutabelën me foljet e dhëna sipas kohës së kërkuar.
- Ushtrimi 2 synon që nxënësit të vendosin foljet në kohën e kërkuar.

Pasi nxënësit i përfundojnë ushtrimet, bëhet leximi dhe korrigjimi i tyre. Shkruhen në tabelë foljet ku nxënësit hasin vështirësi.

Ushtrimi 3 zhvillohet në dyshe ku njëri nxënës kthen foljen në kohën e kryer të thjeshtë dhe nxënësi tjetër formon fjali me të.

Ushtrimi 4 punohet me shokun e bankës. Qarkoni foljet që janë shkruar gabim.

Nxënësit në dyshe pasi qarkojnë dhe korrigjojnë gabimet shkëmbejnë librat me dyshe tjetër dhe bëjnë korrigjimet e duhura. Diskutohet ushtrimi me të gjithë klasën.

Reflektim.

Udhëzohen nxënësit të hapin Fletoren e punës dhe të punojnë ushtrimet në mënyrë të pavarur.

Ushtrimi 1 synon që nxënësit të zgjedhoni foljet në tabelë.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit të plotësojnë vendet bosh me foljet *marr, shoh, jap, dal, ha*, në kohën e kryer të thjeshtë.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit të vendosin foljet *kam* dhe *jam* në formën e duhur.

Pasi nxënësit i punojnë ushtrimet e tekstit, bëhet korrigjimi i tyre.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për

- zgjedhimin e foljeve *jam, kam, marr, shoh, jap, dal, ha* në kohët e thjeshta të mënyrës dëftore
- për gjetjen e kohës, vetës dhe numrit të foljeve të dhëna
- korrigjimin e foljeve të shkruara gabim dhe shkrimin e saktë të tyre.
- krijimin e fjalive duke përdorur foljet *marr, dal, jap, shoh* në veta dhe numra të ndryshëm.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në Fletoren e punës u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 20

Numërorët

Arritjet e të nxënit:

Nxënësi/ja është në gjendje:

- Dallon numërorët në një tekst të dhënë.
- Përcakton llojin e numërorit.
- Shkruan saktë numërorin e dhënë.
- Krijon fjalë duke përdorur lloje të ndryshme të numërorëve

Metodat dhe teknikat: Brainstorming, punë e drejtuar, punë e pavarur, shkëmbe një problemë.

Korrelacion: Matematikë, Shoqëria dhe mjedisi.

Fjalë kyçe: numëror, themelor, thyesor

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, fisha me numërorë të ndryshëm, flipçarte me lloje të ndryshme numërorësh.

Evokim:

Çfarë ju bie ndërmend kur dëgjoni fjalën NUMËRORI?



NUMËRORI

Jepni disa prej tyre.

Shkruhen në tabelë mendimet e nxënësve.

Udhëzohen nxënësit që të lexojnë në heshtje fjalitë e dhëna. Gjeni numërorët. Diskutohen gjetjet e tyre.

Realizim kuptimi.

Numërorët janë fjalë që shënojnë sasi të caktuar (tri mollë, dhjetë libra, tre lapsa, dy këngë)

Numërori mund të jetë:



1. themelor, tregon: sasi të caktuar frymorësh a sendesh.

2. thyesor, që tregon pjesë të sasisë së frymorëve ose të sendeve.

3. rreshtor, që tregon radhën e sendeve ose të frymorëve dhe sillet si mbiemër, duke u përshtatur në numër, gjini dhe rasë me emrin me të cilin lidhet.

Kujdes!

Numërori 3 del me trajtë të ndryshme në gjininë femërore: tri shoqe dhe ndryshe në

gjininë mashkullore: tre shokë.

Numërorët mund të përdoren të shoqëruar me emra: dy djem, tri vajza etj., ose më vete, si në veprimet matematikore $8 \times 3 = 24$

Kujdes me shkrimin e numërorëve:

Numërorët thyesorë: $\frac{3}{5}$ ose tre të pestat, dalin në formën e gjinisë femërore dhe lakohen në trajtën e shquar.

Shkruhen bashkë 0-10, 11 - 20, 20, 30,... 100, 200, 300...999

Shkruhen ndaras 21 (njëzet e një),... 29 (njëzet e nëntë)... 101 (njëqind e tre) 1000 (një mijë),... 1975 (një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë).

Numërorët rreshtorë, kur paraqiten me shkronja romake, nuk marrin nyje as para, as pas:



Klasa e dytë- Klasa II, por Klasa e 2-të.

Puna me tekstin

Lexohen dhe diskutohen ushtrimet e tekstit me gjithë klasën.

Ndahet klasa në 3 grupe

Grupi i parë do të punojë ushtrimin 1 - Shkruani me shkronja numërorët e mëposhtëm.

Grupi i dytë do të punojë ushtrimin 2 - Përgjigjuni duke shkruar numërorin me fjalë.

Grupi i tretë do të punojë ushtrimin 3 - Shënoni me V (e vërtetë) ose G (e gabuar).

Secili grup prezanton punën e tij para klasës. Nxënësit e tjerë plotësojnë rubrikat e tjera të tekstit.

Reflektim.

Punë individuale

Udhëzohen nxënësit që të hapin fletoret e punës

Sqarohen rubrikat dhe nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.

Më pas bëhet korrigjimi i detyrave dhe shkruhen në tabelë ushtrimet ku nxënësit kanë shfaqur paqartësi

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për:

- Dallimin e numërorëve në një tekst të dhënë.
- Shkruan saktë numërorin e dhënë
- Krijon fjali duke përdorur lloje të ndryshme numërorësh

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

PJESA E TRETË

Mësimi 21

Llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit

Arritjet e të nxënit:

Janë në gjendje:

- Të analizojnë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Të përdorin drejt shenjat e pikësimit (pikën, pikëpyetjen, pikëçuditjen).
- Të shkruajnë fjali sipas kumtimit, formës dhe ndërtimit.
- Të përdorin shenjat e pikësimit në fjali.
- Të dallojnë llojin e fjalive.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali pyetëse, fjali nxitëse.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Në tabelë shkruhen fjalët:

fshat kaloi Marku i pushimet në

Rikujtojmë që *fjalët që bashkohen dhe lidhen me njëra-tjetrën për nga kuptimi quhen fjali*. Nga kjo vërejnë që fjalët e shkruara lart, duhen renditur sipas kumtimit për të formuar fjalinë:

Marku i kaloi pushimet në fshat.

Çdo gjë, që ne shohim ose e mendojmë, e tregojmë ose e shkruajmë me dy ose më shumë fjalë, është një fjali. Fjalia fillon me shkronjë të madhe dhe në fund të fjalisë vendosim shenjë të pikësimit (., ! ose?).

Realizim kuptimi.

Në tabelë vizatohet ose paraqitet me projektor një pamje e ditës me diell.

Me ndihmën e ilustrimit formohen fjali të ndryshme:

Çfarë dite është sot? Sot është ditë me diell. O, sa ditë e bukur kjo!

Si është Dielli? Dielli është i nxehtë. Ua, paska dalë Dielli!

Nxënësit kuptojnë që me anë të fjalisë ne mund të pyesim, të përshkruajmë diçka, të shprehim një dëshirë, urim, mallkim, urdhër, këshillë, lutje etj.

Nxënësit udhëzohen të dallojnë llojet e fjalive. Tërhiqet vëmendja e nxënësve për intonacionin me të cilin lexohen fjalitë, si dhe për shenjat e pikësimit në fund të fjalive. Shpjegohen kuptimi dhe dallimi ndërmjet fjalive.

Rikujtojmë:

Fjali dëftore - me anë të saj tregojmë diçka. Përfundon me pikë (.)

Fjali pyetëse - me anë të saj pyesim. Përfundon me pikëpyetje (?)

Fjali nxitëse - me anë të saj bëjmë një kërkesë, japim një porosi apo urdhër. Zakonisht përfundon me pikë (.); kur shoqërohet me intonacion urdhërues, përfundon me pikëçuditje (!).

Fjali dëshirore –me anë të saj shprehim dëshirë, urim ose mallkim. Përfundon me pikëçuditje (!).

Ushtrimi 1. Nxënësit qarkojnë shenjat e pikësimit të përdorura në tekst dhe arsyetojnë përdorimin e atyre shenjave në fjali.

Ushtrimi 2. Udhëzohen të lexojnë fjalët e dhëna dhe me ndihmën e tyre të formojnë fjali dhe të përdorin shenjë e duhur të pikësimit, duke argumentuar se cili lloj i fjalive është.

Ushtrimin 3 dhe 4 punojnë në mënyrë të pavarur.

Para se të plotësojnë Ushtrimin 5, nxënësit të ndarë në çift, zhvillojnë një dialog për sportin e tyre të preferuar duke diskutuar dhe përdorur sa më shumë fjali dëftore, pyetëse, nxitëse ose dëshirore.

Punë me Fletore pune

Ushtrimi 1. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve duke treguar për secilin lloj të fjalisë çfarë shpreh me të dhe me cilën shenjë të pikësimit përfundon (bazuar në njohuritë e fituara më parë).

Ushtrimi 2. Përcaktojnë llojin e fjalive të dhëna duke diskutuar me shokë dhe argumentuar përgjigjet.

Ushtrimi 3 punohet në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 22

Theksi i fjalës dhe theksi i fjalisë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dijë të vendosë theksin në një fjalë të dhënë.
- Të kuptojë që ndryshimi i theksit sjell edhe ndryshim kuptimi tek fjalët.
- Të dallojë theksin e fjalës dhe theksin e fjalisë

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjalë kyçe: theks i fjalës, theks i fjalisë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Mësuesja i nxit nxënësit që të shqiptojnë emrin e tyre duke u ndalur se cila prej rrokjeve duket se theksohet më shumë. Fëmijët dëgjojnë njëri-tjetrin dhe plotësojnë ose japin mendimin e tyre për shqiptimin e emrave të shokëve.

Realizim kuptimi.

Lexohet pjesa në tekst, të cilën mësuesja e projekton dhe ndalen në fjalët me të zeza. Pyet nxënësit: fjala **bari** a ka ndonjë shqiptim tjetër? A ndryshon kuptimi i saj? Atëherë merren me radhë fjalët.

Në fund mësuesja sqaron se në gjuhën shqipe, njëra nga zanoret e fjalës shqiptohet me forcë më të madhe është më e gjatë se zanoret e tjera të fjalës.

Provojnë të shqiptojnë fjalët gjení - gjéni dhe drejtóri - drejtorí. Vihen në dukje ndryshimet në shqiptim dhe kuptim.

Shkruhet në tabelë fjalía: Bredhat e lashtë filluan të zhurmërojnë më **fórt**. Cila fjalë shqiptohet më shumë se të tjerat? Mësuesja sqaron se edhe në fjali njëra fjalë shqiptohet me theks dhe dallohet nga të tjerat. Zakonisht theksi i fjalisë bie mbi fjalën e fundit, Punohet Ushtrimi 1 i cili kërkon vendosjen e theksit tek fjalët e dhëna.

Punohet bashkë me mësuesen. Pastaj kalohet tek Ushtrimi 2 ku nxënësit duhet të plotësojnë vendet bosh me fjalët e dhëna.

Reflektim.

Punohet në fletoren e punës në mënyrë të pavarur Ushtrimi 1 i cili kërkon që të gjenden fjalë që u ndryshon kuptimi vetëm nga ndërrimi i theksit.

Punohet në vijim ushtrimi 2 dhe 3. Mësuesja ndjek punën e nxënësve. Diskutohen në fund.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 23

Fjalja dëftore

Arritjet e të nxënësve:

Janë në gjendje:

- Të analizojnë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Të përdorin drejt shenjat e pikësimit (pikën, pikëçuditjen)..
- Të përdorin drejt shenjat e pikësimit në fjali.
- Të dallojnë llojin e fjalive.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali dëftore, fjali nxitëse.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim.

Rikujtojnë se çfarë është fjalia. Çdo gjë që ne shohim ose e mendojmë e tregojmë ose e shkruajmë me dy ose më shumë fjalë është një fjali. Fjalia fillon me shkronjë të madhe dhe në fund të fjalisë vendosim shenjën e pikësimit (. !?).

Paraqiten në projektor ose shkruhen në tabelë fjalitë:

Po afronte ora për në shkollë.

Marta po flinte.

Marta nuk po i hapte sytë.

Në këto fjali vërejnë që po tregohet ose përshkruhet diçka. Këto lloje fjalish nxënësi kuptojnë që janë fjali dëftore me anë të së cilës (japin mendimet e tyre për fjalitë) jepet një informacion, shprehet një mendim, bën përshkrim ose tregon veprim.

Realizim kuptimi.

Nxënësi kuptojnë që kur përshkruajnë diçka me ndjenjë të veçantë (habi, gëzim, hidhërim, frikë etj.) këto fjali dëftore quhen fjali dëftore- thirrmore. Në fund të saj vendoset pikëçuditje.

Ah, sa i bukur është vendi!

Sa keq më erdhi! (tek dëgjova për ndonjë situatë)

Çfarë dite me fat kjo e sotmja!

Nxënësi udhëzohen të lexojnë dhe të analizojnë në tekstin mësimor si fjalitë dëftore i dallojnë nga intonacioni dhe rendi i fjalëve.

Rendi i fjalëve.

1. Kryefjala 2. Kallëzuesi 3. Fjalët plotësuese.

Kur duam të theksojmë njërin nga përbërësit e fjalisë, atë e nxjerrim para kryefjalës.

Fjalët plotësuese. 2. Kallëzuesi. 3. Kryefjala

Shembull

Mësuesja u foli fëmijëve për ditën e parë të shkollës.

Fëmijëve, për ditën e parë të shkollës, u foli mësuesja.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë e të dallojnë fjalitë dëftore në tekst. Kërkohet që nxënësit të shkruajnë nga një fjali dëftore – thirrmore me anë të së cilës do të shprehin: gëzim, habi ose frikë.

Ushtrimi 2. Fjalitë e dhëna pohore i kthejnë në fjali mohore.

Ushtrimi 3 dhe 4 punohet në mënyrë të pavarur.

Reflektim.

Punë me fletore pune.

Së bashku me nxënësit rikujtohen njohuritë e fituara më parë dhe ftohen nxënësit që t'u përgjigjen në pyetjet e dhëna.

Ushtrimi 2. Analizohen fjalitë e dhëna dhe tregojnë se çfarë shprehin më anë të atyre fjalive (gëzim, habi, shqetësim, frikë).

Ushtrimi 3 dhe 4 punohen në mënyrë të pavarur duke vendosur shenjat e duhura të pikësimit në fund të fjalive.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 24

Fjala pohore dhe fjalia mohore

Arritjet e të nxënit: Janë në gjendje të :

- Analizojnë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Dallojnë fjalinë pohore dhe mohore
- Përdorin pjesëzat e duhura për formimin e fjalisë mohore
- Krijojnë fjali pohore dhe mohore

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali pohore, fjali mohore, pjesëza mohuese

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, Fletore e punës, projektor.

Evokim:

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i shpërndahen etiketa me fjalë dhe kërkohet që të formojnë fjali me ato fjalë. Fjalitë që formohen, duhet të jenë dy pohore dhe dy mohore.

Gr. 1. Lira mëson mirë.

Gr. 2. Mira vizaton bukur.

Gr. 3. Lira nuk luan me shoqe.

Gr. 4. Gjoni nuk lexon bukur.

Fjalitë e formuara shkruhen në tabelë. Kërkohet nga grupi i parë dhe i dytë që pjesëzën mohuese "nuk" ta fusin në mes emrit dhe foljes dhe në këtë mënyrë të lexojnë dhe të bëjnë dallimin në mes të fjalisë pohore dhe mohore.

Realizim kuptimi:

Nxënësit lexojnë tekstin e dhënë duke dalluar fjalitë pohore dhe mohore në tekst.

Kuptojnë që me fjalitë mohore ne mohojmë ose kundërshtojmë diçka.

Me fjalitë pohore miratojmë diçka të vërtetë.

Vërejnë dallimin në mes fjalisë pohore dhe fjalisë mohore dhe përdorimin e drejtë të pjesëzave mohuese.

Ushtrimi 1: fjalitë lexohen nga nxënësit dhe dallohen fjalitë pohore nga fjalitë mohore.

Ushtrimi 2 dhe 3 punohen në çift, një nxënës lexon fjalitë e dhëna pohore ndërsa tjetri i kalon ato në fjali mohore dhe fjalitë mohore kalohen në fjali pohore.

Ushtrimi 4: nxënësit formojnë fjali duke përdorur fjalët: **asnjë, askush, asgjë, askund.**

Reflektim.

Punë me fletore pune.

1. Nxënësit ftohen të tregojnë dallimin në mes fjalive pohore dhe mohore nëpërmjet shembujve.
2. Fjalitë e dhëna pohore lexohen nga një nxënës, ndërsa nga një nxënës tjetër kalohen në fjali mohore. Plotësohen në fletore pune.
3. Ushtrimi 3 dhe 4 punohet në mënyrë të pavarur.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 25

Fjala nxitëse dhe dëshirore

Arritjet e të nxënit

Është në gjendje:

- Të analizojë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Të vërejë dallimin në mes fjalisë nxitëse dhe dëshirore.
- Të argumentojë shenjat e pikësimit në tekste.
- Të krijojë fjali nxitëse dhe dëshirore.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali nxitëse, fjali dëshirore.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Mësuesi paraqet me shkumës një pikë në tabelë, vazhdon duke prekur me shkumës tabelën dhe duke goditur në mënyrë që të nxisë nxënësit të dëgjojnë me vëmendje. Kur të gjithë nxënësit drejtojnë shikimin nga mësuesi u përgjigjen pyetjeve:

Çfarë ka shënuar mësuesi në tabelë?

Kuptojnë dhe tregojnë që mësuesi ka shënuar disa pika.

Në këtë mënyrë treguan diçka.

Vazhdon pyetja tjetër.

Po, kur mësuesi i binte tabelës me shkumës?

Çfarë donte të arrinte ai?

Nxënësit kuptojnë që më këtë mënyrë mësuesi i ka nxitur ata që të dëgjojnë me vëmendje.

Realizim kuptimi:

Lexojnë fjalitë e dhëna të teksti mësimor dhe kuptojnë që:

Fjala nxitëse kumton sugjerim, porosi, kërkesë, urdhër, lutje, këshillë etj. dhe me të synojmë të nxisim ose ta ndalojmë dikë për kryerjen e një veprimi. Përgjithësisht përfundon me pikë. Kur fjalia është nxitëse – thirrmore, përfundon me pikëçuditje.

Fjala dëshirore kumton urim, mallkim, dëshirë dhe përfundon me pikëçuditje, pasi është gjithmonë thirrmore.

Ushtrimi 1 dhe 2. Shkruajnë nga një fjali nxitëse dhe dëshirore për çdo rast të dhënë.

Ushtrimi 3 dhe 4 punohet në mënyrë të pavarur, kontrollohet saktësia e punës.

Nxënësit shprehin lirshëm mendimet lidhur me këtë fjalë, duke përfshirë edhe urimet më të bukura që mund të kenë dëgjuar. Mbas përfundimit të aktivitetit me shumë lehtësi mund të plotësojnë ushtrimin.


Punë me fletore pune.

Ushtrimi 1 lidhin fjalitë nxitëse dhe fjalitë dëshirore me atë që ato mund të shprehin.

P. sh. : fjali nxitëse- sugjerim, urdhër etj, fjali dëshirore – urim, mallkim etj.

Ushtrimi 2 – gjejnë fjalët e dhëna (*sugjerim, lutje, këshillë, urim, ftesë*) në mes shkronjave

Ushtrimi 3 Përcaktojnë llojin e fjalive në fjalitë e dhëna.



Ushtrimi 4 Nxënësit ndahen në grupe, secilit grup i përcaktohet njëra nga shprehjet e dhëna dhe me përdorimin e tyre formojnë fjali dëshirore.

gr. 1 u bëfsh, gr. 2 gëzofsh gr.3 ardhhtë gr.4 fitoftë gr. 5 mbledhtë .

Diskutohet dhe analizohen fjalitë e formuara pastaj plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrën.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 26

Fjalja pyetëse

Arritjet e të nxënit.

Është në gjendje:

- Të analizojë fjalitë në tekstet e dhëna.
- Të identifikojë fjalitë pyetëse në tekst.
- Të shkruajë fjali duke përdorur fjalët pyetëse.
- Të përdorë saktë shenjën e pikësimit.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: fjali pyetëse, pyetëse tërësore, pyetëse të pjesshme.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Nxënësve u paraqitet me projektor fotografia e fshehur e një personazhi mbas numrave 1- 9. Nxënësit, duke zgjidhur nga një numër mundohen të zbulojnë personazhin e fshehur. Ftohen që të bëjnë sa më shumë pyetje, të cilave mësuesi mund t'u përgjigjet vetëm me *po* ose *jo*.

Pyetjet e mundshme:

A është i/ e njohur?

A është sportist/ sportiste?

A është këngëtar/ e? etj.

Mbasi të zbulohet fotografia, diskutohet për pyetjet që nxënësit kanë bërë.

Në tabelë shkruhen disa pyetje për të cilat nxënësit japin përgjigjet sipas mendimit të tyre.

Përse shkon në shkollë çdo fëmijë?

Përse duhet të zgjohemi në mëngjes?

Përse Dielli fshihet?

Përse bie shi? etj.

Kujtojnë që fjalitë pyetëse ndërtohen me pyetjet: Kush?, Cili?, Ku? Si? Kë? Përse? Çfarë? Pse?

Gjithashtu disa fjali pyetëse ndërtohen edhe pa këto fjalë pyetëse.

P. sh. : E takove shoqen? A e more vesh lajmin?

Realizim kuptimi:

Nxënësit lexojnë dhe kuptojnë njohuritë kryesore për fjalitë pyetëse.

Shënojnë në fletore dhe mbajnë mend.

Fjalja pyetëse përdoret për të bërë pyetje. Në fund të saj vëmë pikëpyetje. Kur pyetja shoqërohet me habi, fjalja është pyetëse-thirrmore dhe përfundon me ?!. Fjalitë pyetëse mund të ndërtohen edhe me *a, kur, çfarë, ku, kush, cili, cila, cilët, cilat* etj., në fillim të tyre.

Fjalitë pyetëse mund të jenë:

Pyetëse tërësore: kur ka mënyra të ndryshme për t'iu përgjigjur, p. sh. me "po", me "jo", me foljen e fjalisë pyetëse. - *Do të vini me ne. -Po. / Do të vijmë.*

Pyetëse të pjesshme: kur përgjigjja mund të jepet me një pjesë të fjalisë pyetëse. –Cila është zgjidhja e saktë e ushtrimit? – Zgjidhja e dytë.

Ushtrimi 1. Dallojnë fjalitë pyetëse tërësore dhe fjalitë pyetëse të pjesshme, vendosin shenjën e duhur në fund të fjalive.

Ushtrimi 2. Nxënësit dallojnë pyetjet tërësore dhe përgjigjen me "po" ose "jo".

Para se të plotësojnë ushtrimin nr. 3 nxënësit kuptojnë që kur në një fjalë përveç se pyesim edhe habitemi, atëherë kemi fjali pyetëse - thirrmore. Në fund të kësaj fjalie kemi dy shenja të pikësimit të lidhura me njëra-tjetrën (!!)

P. sh. : Si ta marr vesh se cili je?!

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë kërkesat e detyrave në vazhdim duke kontrolluar dhe vlerësuar punën.

Punë me fletore pune

Ushtrimi 1. Nxënësit plotësojnë vendet bosh me fjalë, me anë të të cilave do të formojnë fjali pyetëse.

Ushtrimi 2. Fjalitë e dhëna i kthejnë në fjali pyetëse.

Reflektim.

Ushtrimi 3. Nxënësit ndahen në grupe

Bëjnë biseda duke përdorur fjalitë pyetëse. Mund të bazoheni në biseda të përditshme ose tema interesante, p. sh. :

Planifikimi i një fundjave.

Gjërat që ju pëlqejnë më shumë: libra, filma ose muzikë.

Plani i punës për javën e ardhshme.

Organizimi i një udhëtimi apo aktiviteti të ardhshëm.

Ushtrimi 4, analizojnë, diskutojnë dhe përcaktojnë llojin e fjalive

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 27

Ligjërata e drejtë dhe ligjërata e zhdrejtë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë.
- Të dallojë ndryshimet që ndodhin në fjali kur kalohet nga njëra ligjëratë tek tjetra.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë e pavarur, krijim i lirë.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjale kyçe: ligjëratë e drejtë, ligjëratë e zhdrejtë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, projektor.

Evokimi:

- Mësuesja shkruan në tabelë një fjali: Sa është ora? Pyet nxënësit se çfarë shenje pikësimi është vendosur. A mund ta drejtojmë pyetjen në një formë tjetër? Le ta provojmë së bashku. Po tani çfarë shenje pikësimi duhet vendosur?

Realizim kuptimi.

Lexohet me vëmendje pjesa në tekstin mësimor, të cilin e projekton në tabelë. Drejton pyetjet: Sa bashkëbisedues kemi? Çfarë shenje pikësimi është vendosur në fjalitë e ndryshme të dialogut.

Mësuesi shpjegon:

- 1) Ligjërata e drejtë: Nëse riprodhimi i fjalëve nga folësi kryhet me përpikëri pa ndryshuar asgjë.**
- 2) Ligjërata e zhdrejtë: Nëse riprodhimi i fjalëve nga folësi shprehet me disa ndryshime, si p. sh. veta, koha e foljeve etj.**

Punohet me nxënësit ushtrimi 1 që kërkon që të dallohen fjalitë në ligjëratë të drejtë prej atyre në ligjëratë të zhdrejtë. Kalohet tek ushtrimi 2 që kërkon që të kthehet ligjërata e drejtë në ligjëratë të zhdrejtë. Diskutohet rreth tyre. Punohet ushtrimi 3 në mënyrë të pavarur.

Reflektim.

Punë në fletore pune.

Ushtrimi 1. Plotësohet shpjegimi.

Udhëzohen nxënësit të lidhin shprehjet me ligjëratën e drejtë ose të zhdrejtë.

Kalohet tek ushtrimi 3. Lexohet pjesa me vëmendje e pastaj nxënësit u përgjigjen pyetjeve. Diskutohet e vlerësohet saktësia e përgjigjeve.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 28

Rregullat e shkrimit të ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë

Arritjet e të nxënit:

Nxënësi/ja janë në gjendje:

- Njohin rregullat e shkrimit të ligjëratës së drejtë.
- Njohin rregullat e shkrimit të ligjëratës së zhdrejtë.
- Përdorin saktë shenjat e pikësimit.

Metodat dhe teknikat: brainstorming, punë me grupe, punë individuale.

Korrelacion: njohuri për natyrën.

Fjalë kyçe: ligjëratë, shenjë pikësimit.

Mjetet e mësim: teksti mësimor, fletore e punës, projektor.

Evokim:

Mësuesja i fton nxënësit të kujtojnë së çfarë kanë mësuar për ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë. U kërkon nxënësve shembuj të krijuar nga vetë ata.

Realizim kuptimi.

Mësuesja projektton shembujt:

"Kush do të vijë të shohim ndeshjen e futbollit në mes klasave të pesta?" - u tha shokëve.

U tha shokëve: "Kush do të vijë të shohim ndeshjen e futbollit në mes klasave të pesta?"

"Duhet të shkojmë herët për biletat, - tha Rei, - që të zëmë vende të mira. "

"Ndeshjen e fitoi skuadra jonë!", - thirri Gea.

Sqarohen shenjat e pikësimit të vendosura në secilin rast. Kalohet në rastet e tjera:

Ajo po mendonte: "A duhet t'u tregoj shoqeve për telefonatën e Amlës?"

Ajo po mendonte nëse duhet t'u tregonte shoqeve për telefonatën e Amlës.

Krahasoni shembujt. A ka ndryshuar koha e foljes? Po tjetër çfarë ndryshon?

Kalohet në grupin e fundit të shembujve në dialog:

Ç - Vemi kur të duash, por jo sot, se e kemi pushim.

A - Pse?

Ç - Mësuesja është me grip, kështu që nuk kemi mësim.

Ushtrimi 1 dhe 2 punohet bashkë me mësuesin. Në Ushtrimin 1 zgjidhet dhe argumentohet alternative e saktë. Mësuesja drejton edhe Ushtrimin 2 duke orientuar nxënësit për shenjën e duhur të pikësimit.

Punohen në vijim nga vetë nxënësit Ushtrimi 3 dhe 4.

Reflektim.

Punohet në fletore pune ushtrimi ku nxënësit plotësojnë tabelën me rregullat e duhura.

Ushtrimi 2 dhe 3 nxënësit do të kthejnë fjalitë nga ligjëratë e drejtë në të zhdrejtë.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 29

Kryefjala dhe kallëzuesi, fjalë e thjeshtë

Arritjet e të nxënës:

Nxënësi/ja është në gjendje:

- të dallojë kryefjalën në fjali duke përdorur pyetjet: *Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?*;
- të dallojë kallëzuesin në fjali duke përdorur pyetjet: *Ç'bën? Ç'bëri? Ç'do të bëjë?*
- të përcaktojë sesi formohet fjalë e thjeshtë;
- të përcaktojë sesi formohet fjalë e përbërë;
- të tregojë se me se shprehet kryefjala në fjali;
- të zgjerojë fjalitë e thjeshta në fjali të përbëra;
- të demonstrojë besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve;
- të bashkëpunojë në grup për kryerjen e një detyre;
- të vlerësojë punën e shokëve/shoqeve.

Metodat dhe teknikat: harta e konceptit; dallo-diskuto; shkrim i drejtuar; punë individuale, punë në çift, punë në grup, punë me gjithë klasën.

Korrelacion: matematika, shoqëria dhe mjedisi.

Fjalë kyçe: gjymtyrë kryesore; kryefjalë; pyetjet: *Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?*

Kallëzues; Pyetjet: Ç'bën? Ç'bëri? Ç'do të bëjë?

Mjetet e mësimit: njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësit/es; teksti mësimor; fisha me pyetjet për të gjetur kryefjalën; fisha me fjali; mjete shkrimi, lapsa me ngjyra, fletore, tabakë letre, fletë A 4.

Evokim:

Kujtojmë! Çfarë mbajmë mend për kryefjalën dhe kallëzuesin?

Nxiten nxënësit që në grupe të plotësojnë hartën e konceptit për kryefjalën dhe kallëzuesin të cilën përfaqësohet e grupeve e prezantojnë para klasës.

Kryefjala

Kallëzuesi

Realizim kuptimi.

*Kryefjala tregon atë për të cilën flitet në fjali, atë që kryen veprimin e shprehur nga kallëzuesi dhe vendoset para tij. Ajo shprehet me emër në rasën emërore. Për ta gjetur kryefjalën, i bëjmë kallëzuesit pyetjet: *Kush? Cili? Cila? Cilët? Cilat?**

*Kallëzuesi tregon çfarë bën kryefjala. Për të gjetur kallëzuesin, i drejtojmë pyetje kryefjalës: *Ç'bën? Ç'bëri? Ç'do të bëjë? etj.**

Kallëzuesi përshtatet me kryefjalën në vetë dhe në numër.

Fjala që ka vetëm një kallëzues quhet fjali e thjeshtë. Fjala që ka dy a më shumë kallëzues quhet fjali e përbërë.

Udhëzohen nxënësit të lexojnë në heshtje tekstin e dhënë.

Pasi e kanë lexuar ata gjejnë dhe nënvizojnë fjalitë e thjeshta.

Çdo fjali e thjeshtë ka një grup fjalësh që përbëjnë bërthamën e saj, p. sh. : Vajza ishte përqendruar te ekrani i kompjuterit të mësueses.

Kjo është një fjali e thjeshtë, sepse ka një folje dhe kumton një informacion të plotë.

Le ta zvogëlojmë aq sa të mos priset kuptimi i fjalisë.

Vajza ishte përqendruar te ekrani i kompjuterit të mësueses.

Vajza ishte përqendruar te ekrani.

Vajza ishte përqendruar. —kjo është edhe bërthama e fjalisë së thjeshtë, që përbëhet nga kryefjala e kallëzuesi.

Por fjalia: Vajza i shikonte kompjuterin mësueses, kasi bërthamë: "Vajza i shikonte kompjuterin." sepse nuk ka kuptim vetëm kryefjala me kallëzuesin në këtë rast "Vajza shikonte. "

Punohen ushtrimet e tekstit me radhë.

Pasi klasa ndahet në 4 grupe, udhëzohen që të punojnë së bashku ushtrimet e tekstit.

Ushtrimi 1 synon që nxënësit të lidhin fjalët e dhëna dhe të formojnë fjali të thjeshta.

Ushtrimi 2 synon që nxënësit të zgjerojnë fjalitë e ushtrimit 1.

Ushtrimi 3 synon që nxënësit të zvogëlojnë fjalitë derisa të marrin fjalinë më të vogël ose fjalinë bërthamë.

Ushtrimi 4 synon që nxënësit të dallojnë kryefjalën dhe kallëzuesin dhe të tregojnë se me se shprehen.

Diskutohen me grupin zgjidhjet e ushtrimeve dhe më pas me të gjithë klasën.

Reflektim.

Punë individuale

Udhëzohen nxënësit të hapin fletoret e punës. Pasi bëhen sqarimet përkatëse, nxënësit punojnë ushtrimet 1-3 të tekstit. Në fund të orës bëhet vlerësimi i tyre. Shkruhen në tabelë ushtrimet ku nxënësit kanë shfaqur paqartësi.

Vlerësimi bëhet për:

- Dallimin e kryefjalës në fjali.
- Dallimin e kallëzuesit në fjali.
- Tregon se me se shprehet kryefjala në fjali.
- Zgjeron fjalitë e thjeshta në fjali të përbëra.
- Demonstron besim dhe vullnet në arritjen e rezultateve.
- Bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 30

Kryefjala, si gjymtyrë kryesore dhe me se shprehet ajo

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë kryefjalën si pjesë kryesore në fjali.
- Të tregojë me se shprehet kryefjala.
- Të përdorë saktë pyetjet për gjetjen e kryefjalës.
- Të formojë fjali ku kryefjala shprehet me emër, përemër ose grup emëror.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, të nxënit bashkëpunues, punë në grupe, punë e pavarur, krijim i lirë.

Korrelacion: njohuri me shoqërinë.

Fjale kyçe: kryefjalë, emër, grup emëror, përemër, kush? cili? cila? cilat? cilët?

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Paraqesim në një tabak letre fjalitë:


1. **Princi** trokiti në pallatin mbretëror. (*Kush?*)
2. **Ai** i kërkoi mbretëreshës mollën. (*Cili?*)
3. **Molla e kuqe** kishte brenda princeshën. (*Cila?*)

Gjejmë kryefjalën në secilën fjali, duke përdorur pyetjet përkatëse. (*Kush? Cili? Cila?*)

Pyetja *Kush?* Përdoret vetëm për njerëz.

Pjesë kryesore e fjalisë që u përgjigjet pyetjeve:

Kush?, Cila?, Cili? Cilët?, Cilat?



Realizimi i kuptimit:

Lexohet teksti i dhënë në libër ku dallohet kryefjala që shprehet me: **emër** (zogu), **përemër** (unë, ajo) dhe **grup emëror** (zogu i vogël, zogu pendëkuq).

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1.

Ngjyrosni me të verdhë kryefjalën dhe me të gjelbër, kallëzuesin.

Sqaroj se kryefjala dhe kallëzuesi janë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Ushtrimi 2.

Plotëso fjalitë me kryefjalë të shprehura me emër, përemër ose grup emëror.

P. sh. Fëmijët luajnë ngriva-shkriva.

Ushtrimi 3-4

Plotësohen në mënyrë të pavarur nga nxënësit dhe më pas diskutohet rreth plotësimit të tyre.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3 në fletore pune.

Reflektimi.

Ushtrimi 4.

Shkruani një tekst të shkurtër mbi qytetin që ju pëlqen më shumë. Nënvizoni kryefjalën dhe kallëzuesin në çdo fjali.

Vlerësohet puna e nxënësve.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 31

Kallëzuesi, si gjymtyrë kryesore dhe me se shprehet ai

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë kallëzuesin në fjali.
- Të përdorë saktë pyetjet për gjetjen e kallëzuesit.
- Të tregojë me se shprehet kallëzuesi.
- Të krijojë me shkrim një tekst me disa fjali duke përdorur kallëzues të ndryshëm.

Metodat dhe teknikat: përvijim i të menduarit, punë e drejtuar, shkrim i drejtuar.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjale kyçe: kallëzues, folje, ç'bën?, folje + mbiemër, folje + emër.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Paraqesim në një tabak letre fjalitë e mëposhtme:


1. Trajneri **stërvit** sportistët. (Ç'bën trajneri? – tregon veprim)
2. Trajneri **është i mirë**. (Si është trajneri? – tregon si është kryefjala - jam + mbiemër)
3. Trajneri **është futbollist**. (Çfarë është trajneri? – tregon çfarë është kryefjala – jam + emër)

Është gjymtyrë kryesore e fjalisë

Kallëzuesi Tregon ç'bën?, si është? dhe çfarë është? kryefjala

Shprehet me: - folje

- **foljen jam + mbiemër**
- **foljen jam + emër**



Realizimi i kuptimit:

Lexohet teksti i dhënë në libër, ku dallohet kallëzuesi që shprehet me: **folje** (hasen, u ul, shpëtuan, morën), **foljen jam + mbiemër** (ishte e ngushtë, ishte e pamundur), **foljen jam + emër** (ishte një rrëpirë).

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1.

Plotëso fjalitë me një kallëzues duke iu përgjigjur pyetjes "çfarë bën?"

P. sh. Shoferi nget makinën.

Ushtrimi 2.

Nënvizo kallëzuesin dhe thuaj ç'lloj është.

Ushtrimi 3. Plotësohet në mënyrë të pavarur nga nxënësit dhe më pas diskutohet rreth plotësimit të tyre.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3 në fletore pune.

Reflektimi.

Paraqes një pamje para nxënësve rreth të cilës nxënësit krijojnë një tekst ku të përdorin kallëzues të shprehur me *folje*, *folje + mbiemër* dhe *folje + emër*.

Lexohen krijimet nga nxënësit.

Vlerësohen punimet e nxënësve.

Detyrë:

Ushtrimi 4 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 32

Përcaktori

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë grupet e fjalëve të përbëra nga emër + mbiemër ose emër + emër.
- Të dallojë përcaktorin brenda grupit emëror.
- Të krijojë grupe fjalësh me përcaktorë, duke treguar çfarë saktëson ose cilëson përcaktori.
- Të krijojë një tregim duke përdorur përcaktorë.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë në grupe, punë e pavarur, krijim i lirë.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, arte.

Fjalë kyçe: përcaktor, përcakton, cilëson, saktëson, rasa gjinore, rasa rrjedhore, mbiemër, përemër pronor, përemër dëftor.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Rikujtojmë njohuritë: Gjymtyrët e dyta janë plotësuese. Ato plotësojnë kuptimin e kryefjalës dhe kallëzuesit.

Deni **i vogël** lexon përrallën **e Gishtos**.

Mbiemri **i vogël** tregon cilësi të Denit, kurse emri **i Gishtos** përcakton a saktëson përrallën. Këto fjalë që cilësojnë a përcaktojnë një gjymtyrë emërore quhen **përcaktorë**.

- **mbiemër**

Përcaktori shprehet me: - **përemër pronor**

- **emër në rasën: gjinore, kallëzore ose rrjedhore.**

Realizimi i kuptimit:

Lexohet teksti i dhënë në libër ku dallohet përcaktori që:

- **Tregon cilësitë e emrit** – lëvizje **të pakontrolluara**, mollëza **të kuqe**, duart **e vogla** etj.
- **Saktëson emrin** – **ato** lëvizje, **dy** pika etj.

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1-2.

Gjeni përcaktorët dhe tregoni me se shprehen.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3 në fletore pune.

Reflektimi.

Lexoni poezinë me këshillat e L. Gurakuqit dhe shkruani një tekst mbi rëndësinë e shkollës, duke përdorur përcaktorë.

Lexohen disa krijime nga nxënës të ndryshëm. Vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 33

Kundrinori i drejtë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë gjymtyrët plotësuese në grupet e kallëzuesit.
- Të dallojë kundrinorin e drejtë në fjalitë e dhëna.
- Të përdorë saktë pyetjet për gjetjen e kundrinorit të drejtë. (Kë?, Cilin?, Cilët?, Çfarë?)
- Të zbulojë se kundrinori i drejtë është i domosdoshëm në fjali.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë individuale, krijim i drejtuar.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjale kyçe: kundrinor i drejtë, Kë?, Cilin?, Cilët?, Çfarë?, emër në rasën kallëzore, përemër, grup emëror.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Paraqes në fishe fjalinë:

Fëmijët dramatizojnë përrallën.

- Çfarë bëjnë fëmijët? (dramatizojnë përrallën)
- Në ç'rasë është gjymtyra plotësuese? (rasa kallëzore)

Gjymtyra e dytë tregon ku bie veprimi i shprehur nga folja. Ky grup quhet kundrinor i drejtë.

- në rasën kallëzore
- gjymtyrë plotësuese e grupit të kallëzuesit

Kundrinori i drejtë: - plotëson kuptimin e foljes

- **pyetjet kë?** (*frymor*) **çfarë? cilin?** (*jofrymor*)
- **shprehet me: - emër në rasën kallëzore**
- **përemër vetor, dëftor, pyetës etj.**
- **grup emëror**

Jepen shembuj.

- Emër në rasën kallëzore – Megi përgatit **mësimet.**
- Përemër – Në dasmën e Klajdit i ftuam **të gjithë.**
- Grup emëror – Shilës i pëlqejnë **këta libra.**

Realizimi i kuptimit:

Lexohet teksti i dhënë në libër ku gjenden emra në rasën kallëzore të cilat emërtohen si kundrinor të drejtë.

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1- 2-3. Udhëzohen nxënësit të dallojnë kundrinorin e drejtë, duke pasur kujdes

mbaresat rasore dhe pyetjet që bëhen në këtë rast.

Plotësohen fjalitë me kundrinor të drejtë dhe më pas diskutohen me nxënësit.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3-4 në fletore pune.

Reflektimi.

Përshkruani veprimet që kryeni çdo ditë dhe nënvizoni kundrinorin e drejtë.

Lexohen disa krijime nga nxënës të ndryshëm. Vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 3 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 34

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Arritjet e të nxënit:

Është në gjendje:

- Të dallojë kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, me ndihmën e pyetjeve (Kujt?; Cilit?; Cilës?; Cilëve?).
- Të tregojë se me se shprehen kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë.
- Të përdorë kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë në fjali të ndryshme.
- Të dallojë kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë nga kundrinorët e tjerë.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë e pavarur, krijim i drejtuar.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë, Kultura e artit figurativ.

Fjale kyçe: kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë, kujt?, cilit?, cilës?, cilëve?.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Paraqesim fjalinë:

Mësuesja u kërkon nxënësve detyrat e shtëpisë.

Emërtohen fjalët;

- Mësuesja – kush? – kryefjalë
- U kërkoi - ç'bëri? – kallëzuesi
- Nxënësve – kujt? -...
- Detyrat e shtëpisë – cilat? – kundrinor i drejtë

Fjala *nxënësve* është gjymtyrë e dytë e fjalisë që emërtohet kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë:

- **Është gjithmonë në rasën dhanore.**
- **U përgjigjet pyetjeve: Kujt? Cilit? Cilës? Cilëve? Cilave?**
- **Shprehet me: -emër**
- **përemër dhe trajtë të shkurtër**
- **grup emëror**

Jepen shembuj.

- Emër në rasën dhanore - I thashë mësueses.
- Përemër dhe trajtë të shkurtër në rasën dhanore – U kërkoi atyre.
- Grup emëror – Na thirri neve.

Realizimi i kuptimit:

Lexohet teksti dhe nënvizohen emrat në rasën kallëzore dhe rasën dhanore. Dallohen kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë.

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1.

Gjeni kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë në fjalitë e dhëna.

Ushtrimi 2-3.

Dalloni kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë. *(Punë e pavarur)*

Ushtrimi 4.

Dalloni kryefjalën, kallëzuesin, përcaktorin dhe kundrinorin në fjalitë e dhëna.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3-4 në fletore pune.

Reflektimi.

Përshkruani festën e ditëlindjes duke përdorur gjymtyrët që njihni.

Lexohen disa krijime nga nxënës të ndryshëm. Vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

Mësimi 35

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Arritjet e të nxënit

Është në gjendje:

- Të dallojë kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë me ndihmën e pyetjeve.
- Të dallojë me se shprehet kundrinori i zhdrejtë me parafjalë.
- Të përdorë kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë në fjali të ndryshme.

Metodat dhe teknikat: diskutim i ideve, punë e drejtuar, punë e pavarur, krijim i lirë.

Korrelacion: njohuri për shoqërinë.

Fjale kyçe: kundrinor i zhdrejtë me parafjalë, me kë?, për kë?, për cilin?, për çfarë?, prej cilit?.

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fletore pune, mjete të përgatitura nga mësuesi.

Evokimi:

Pyes nxënësit:

- Sa lloje kundrinorësh kemi mësuar?
- Me se shprehen këta kundrinorë?
- Si i gjejmë çfarë lloj kundrinorësh janë?
- Çfarë pyetjesh bëjmë?

Paraqes fjalinë:

Fëmijët shkuan me prindërit në festë.

Emërtohen fjalët;

- fëmijët – cilët? – kryefjalë
- shkuan - ç'bënë? – kallëzuesi
- me prindërit – me kë? – gjymtyrë e dytë e fjalisë; kundrinor i zhdrejtë me parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë:

Shprehet me:

- **emër** : Ata shkuan **me mësuesen** në kinema.
- **përemër**: Ata treguan **për të**.
- **grup emëror**: Ata do të shkojnë **në vend të atyre aktorëve**.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë është gjithmonë në rasën: emërore, kallëzore e rrjedhore shoqëruar me parafjalë.

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë gjendet me pyetjet: për kë? me kë? nga kush? prej kujt? për cilin? me cilin?

Realizimi i kuptimit:

Lexohet pjesa e legjendës dhe gjenden *emrat, përemrat dhe grupet emërore* me parafjalë të cilat emërtohen si kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë.

Kalohet në punimin e ushtrimeve të librit.

Ushtrimi 1.

Gjeni kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë në fjalitë e dhëna.

Ushtrimi 2.

Gjeni kundrinorin dhe dalloni ç'lloj janë.

Ushtrimi 3-4.

Plotësohen në punë të pavarur nga nxënësit. Ata formojnë fjali me fjalët e dhëna, duke i përdorur si kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë, të plotësojnë fjalitë me fjalët e dhëna.

Punim në fletore pune.

Punohet ushtrimi 1-2-3-4 në Fletore pune.

Reflektimi.

Krijo një tekst duke përdorur sa më shumë kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë.

Lexohen disa krijime nga nxënës të ndryshëm. Vlerësohet puna e tyre.

Detyrë:

Ushtrimi 5 në tekstin mësimor u jepet detyrë shtëpie.

